



Shkodër / 2016

Titulli origjinal: *Dünyadaki Cennet*
HUZURLU ÂÏLE YUVASI

Përktheu: Ilir Hoxha
Redaktor: Zija Vukaj
Kryeredaktor: Alban Kali
Design: Bledar Xama



PROGRESI sh.p.k. _____

Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri
Mob: +355 67 60 78484
http: www.progresibotime.com e-mail: botime@progresibotime.com

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797 e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup
Tel: +398 71 956 271 e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Xheneti i kësaj bote

ÇERDHJA
E NGROHTË
FAMILJARE

OSMAN NURI TOPBASH

PARAFJALA

Falënderimet e pafundme i takojnë Allahut të Lartëmadhëruar, i Cili e krijoi birin e njeriut prej një mashkulli dhe një femre, duke vendosur midis tyre një dashuri e cila është burimi i lumturisë së përjetshme! Dhe, në sajë të kësaj dashurie, na ka hapur dyert e dashurisë ndaj Lartmadhërisë së Tij.

Salavatet dhe selamet e pafundme i takojnë Muhamed Mustafasë, salallahu alejhi ue selem, i cili është prijësi dhe shembulli më i përsosur e ideal për një jetë të qetë familjare, e cila do t'i përgatit zemrat tona në pragun e ashkut dhe dashurisë hyjnore!

Pa asnjë dyshim se, dashuria ekziston në natyrën e të gjitha krijesave.

Para se të krijoheshin botët, Allahu i Madhëruar ishte “**një thesar i fshehur**”. Ai dëshiroi të njëjhej dhe për këtë arsye, të gjitha krijesat i krijoi me dashuri. Për rrjedhojë, esenca e të gjitha dashurive, është dashuria hyjnore. Ndërsa të gjitha dashuritë e tjera që Allahu i Madhëruar ia fali robërve të Tij, në të



vërtetë janë shkaqe të përgatitjes dhe ngritjes për tek dashuria ndaj Tij. Dhe, si shkallën më të çmuar për t'u ngritur në dashurinë ndaj Tij, Ai fali dashurinë dhe lidhjen midis burrit dhe gruas. Kurse çerdhen familjare, e cila do të formohet me aktin e nikahut¹ në emrin e Tij të Lartëmadhëruar, e bëri vendin më të mirë dhe më të begatë të kësaj dashurie dhe lidhjeje.

Nga kjo pikëpamje, çerdhja familjare u bë edhe një shkallë e padiskutueshme e dashurisë ndaj Allahut, por edhe një ligj hyjnor për vazhdimësinë e brezave. Pra, ambienti familjar, u bë edhe një nevojë fiziologjike, edhe trualli i parë dhe esencial i zhvillimit shpirtëror.

Për këtë arsye, nga pikëpamja Islame, martesja ka qenë gjithmonë themelore dhe është nxitur jashtëzakonisht shumë. Në fakt, e kundërta e kësaj, është në kundërshtim edhe me krijimin e njeriut, sepse martesja, është një nevojë dhe një sunet i fortë i Pejgamberit ﷺ, prej së cilës njeriu nuk duhet të qëndrojë larg -përveç për arsye të forta e të pranueshme-.

Nisur nga kjo rëndësi kaq e madhe që ka formimi i çerdhes familjare, për të realizuar qëllimet që synohen me martesën dhe për ta kthyer ambientin



familjar në një vend paqe të xhenetit, duhen respektuar me rigorozitet shumë çështje delikate dhe të rëndësishme.

Çfarë duhet bërë për ndërtimin e një jete familjare, e cila do të jetë shkallë për t'u ngritur drejt dashurisë hyjnore? Çfarë duhet pasur kujdes që shtëpitë tona të jenë kopshte paqeje dhe lumturie? Si duhet jetuar që rrugëtimi i jetës sonë familjare të përfundojë me takimin e përjetshëm në botën tjetër? Çfarë duhet siguruar që lumturia e cila realizohet në këtë botë, të vazhdojë edhe në botën tjetër?!

Ja pra, e gjithë çështja, është e fshehur në përgjigjet e këtyre pyetjeve. Mbase, për shkak të kushteve negative të kohës dhe vendit ku jetojmë, këto përgjigje mund të mos jenë evidenca e saktë për të gjithë. Për këtë arsye, Islami i ka rregulluar në mënyrën më të bukur dhe me delikatesë të madhe të gjitha rrugët, metodat, rregullat dhe kriteret që i shpie njerëzit në synimet dhe rezultatet e dëshiruara në jetën familjare. Përveç këtyre, ai na i ka bërë të ditura edhe përfundimet e këqija dhe të rrezikshme në rast se nuk respektohen këto rregulla.

Për të arritur sukses në këtë çështje, pra për një çerdhe të ngrohtë familjare, Allahu i Madhëruar na ka falur shembullin më të bukur dhe më të përsosur. Ai është sulltani i zemrave, Muhammed Mustafai,



salallahu alejhi ue selem. Ky Pejgamber i lartë, në jetën e të cilit nuk gjendet asgjë negative, ka jetuar me të njëjtën pjekuri edhe në çerdhen familjare që ndërtoi. Nisur nga kjo, për ndërtimin e një familje të mirë, ne jemi të detyruar të njohim dhe të marrim shembull jetën e tij familjare të mbushur me nder dhe bukuri të veçanta. Përndryshe, nëse shoqëria në të cilën jetojmë vazhdon të jetë e privuar nga çerdhet e ngrohta familjare plot paqe dhe begatit, ajo do të zhytet në vorbullat e problemeve të pafundme.

Të gjithë e shohim se, shumë prej të rinjve tanë të cilët nuk munden të ndërtojnë një çerdhe familjare të saktë dhe të ekuilibruar, po ia nxijnë jetën vetes dhe fëmijëve të tyre me divorcet e panevojshme. Më e keqja, është se shumë prej tyre qëndrojnë indiferentë dhe nuk i afrohen martesës. Për rrjedhojë ata shkatërrohen në vorbullat e gjynaheve dhe haremeve.

Ja pra, edhe kjo vepër që keni në duar, të cilën e kemi përgatitur enkas për këto dhe shkaqe të tjera të ngjashme, inshAllah -ashtu si edhe veprat e tjera të shkruara në këtë fushë- bëhet melhem, shërues i plagëve familjare të shoqërisë sonë.

Me këtë dëshirë dhe synim, e kemi ndarë këtë vepër në katër pjesë nën këto tituj:



2. Çështjet që duhet të kenë kujdes gratë në familje,

3. Çështjet që duhet të kenë kujdes burrat në familje,

4. Çështjet që duhet të kenë kujdes burrat dhe gratë së bashku në familje,

Në përgjithësi, kjo vepër përbëhet prej reportazheve të botuara në Revistën Shebnem. Por, përveç këtyre janë bërë edhe shtesa të reja.²

Në këtë vepër, në mënyrë të përmbledhur zënë vend njohuri të nevojshme për një familje të qetë e cila do të ndërtohet me kriteret Islame. Këtu janë shpjeguar rregullat dhe parimet e duhura për realizimin e qëllimeve të larta në një martesë dhe, në lidhje me këto, janë dhënë disa shembuj shpjegues. Gjithashtu, janë dhënë edhe shembuj nga jetët e të mëdhenjve të Islamit, e veçanërisht nga jeta e Pejgamberit (a.s.). Në këtë mënyrë, është mbajtur parasysh qëllimi për t'i siguruar lexuesve tanë të nderuar një mendim dhe botëkuptim më të qartë dhe më të pastër.

I lutemi Allahut të Madhëruar, duke dëshiruar

2. Allahu i Madhëruar i bëftë sevape të përhershme përpekjet e O. Faruk Demireshik, i cili ka punuar në përgatitjen e kësaj vepre dhe M. Ali Eshmeli, i cili ka kontribuar në organizimin dhe zgjerimin e saj!



prej Tij që kjo vepër modeste të jetë e dobishme për ata që e kanë ndërtuar një çerdhe familjare dhe, veçanërisht për ata të rinj që ende janë duke e ndërtuar këtë çerdhe.

Zoti ynë na e bëftë të mundur të ndërtojmë familje të forta e të palëkundshme në këtë periudhë kur në të gjithë botën çerdhet familjare po shkatërrohen nga tërmetet e amoralitetit, neglizhencës dhe mungesës së dashurisë! Qofshin shtëpitë tona plot dashuri, paqe dhe lumturi xheneti! Dhe dera e fundit e këtij xheneti, le të hapet në xhenetin e përjetshëm ku do të përjetohet edhe takimi me Allahu e Madhëruar!

Amin!..



Nikahu dhe familja në Islam



*Nikahu, është rruga e peygamberëve,
suneti i Resulullahut, pranvera e
brezave, dinjiteti dhe edukata e
mashkullit dhe e femrës, kalaja e
namusit dhe nderit dhe veçoria dalluese
e njeriut nga krijesat e tjera.*

I nderuar, në ditët tona po zhvillohen shumë debate në lidhje me martesën. Pikësëpari, a janë të detyruar njerëzit të jetojnë në shoqëri dhe të formojnë familje? A nuk është e mundur që ata ta vazhdojnë jetën e tyre të vetëm?

Vetmia dhe njëshmëria i takon vetëm Allahut, sepse Ai Krijues Madhështor, cilësinë e të qenit “një” dhe “**i vetëm**”, e ka bërë të posaçme vetëm për Vetën e Tij dhe, nisur nga kjo, të gjitha krijesat i ka krijuar në çift. Për rrjedhojë, për shkak se janë të krijuara në çift, të gjitha krijesat ndiejnë nevojë për njëra-tjetrën. Po ashtu, për arsye se janë të krijuara, ato kanë dobësi dhe nevoja të ndryshme sipas strukturës së tyre. Pra, të gjitha qeniet e tjera përveç



Allahut, kanë një mijë e një lloje nevojash. Ato kanë nevojë edhe për njëra-tjetrën, por edhe për Allahun e Madhëruar, i Cili i krijoi nga asgjëja.

Midis të gjitha këtyre qenieve, njeriu është në krye të listës për nga nevoja që ndjen për të tjerët. Kjo, sepse nevojat dhe kërkesat e njeriut, janë më të shumta në krahasim me ato të krijesave të tjera. Mbi të gjitha, këto nevoja shtohen vazhdimisht dhe nuk kanë të mbaruar, sepse njeriu dëshiron të jetojë vazhdimisht në një mirëqenie materiale dhe shpirtërore. Vështirësia, skamja, vuajtja, fatkeqësia, etj., i duken shumë të rënda atij. Dhe, veçanërisht në këto momente, ai kërkon një dorë ku të mbahet dhe një zemër ku të strehohet.

Sipas një mendimi, fjala arabe “*insan*”, që do të thotë njeri, nënkupton “familjaritet dhe miqësi”. Kjo, tregon se ai është i nevojshëm për shoqërimin me krijesat e tjera, e në mënyrë të veçantë për shoqërimin me llojin e vet. Kjo nevojshmëri, është veçoria më e spikatur e njeriut. Dhe ai, pothuajse njihet më tepër me këtë cilësi.

Momenti kur ky fakt del më tepër në pah, është në marrëdhënien bashkëshortore. Kjo çështje, për nga aspekti i vazhimit të brezave, është një nevojë e domosdoshme, madje një kusht.



në formën mashkull-femër, ndërsa tek krijesat jo të gjalla, shfaqet në përbërjet kimike plus (+) / minus (-). Në Kur'anin Fisnik kjo çështje, ceket në shumë ajete:

“Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!” (Dharijat, 49)

“Qoftë lavdëruar Ai që i ka krijuar në çift të gjitha llojet; prej çka mbin në tokë, prej vetë atyre (njerëzve) dhe ato që ata nuk i dinë!” (Ja-Sin, 36)

“Ne ju kemi krijuar në çifte.” (Nebe, 8)

Veçoria e krijimit në çift, që përmendet në këto ajete, nuk nënkupton dy copë për çdo lloj krijese, por siç përmendet edhe më lartë, çdo lloj është krijuar në formën “mashkull-femër”, ose “plus-minus”. Përndryshe, krijimi i njëjës prej tyre do të ishte i tepërt dhe kjo panevojshmëri bie ndesh me kuptimin e cilësisë së Allahut, **“el-Muteal”**, pra, zotëruesi i të gjitha cilësive të përsosura. Shkurtimisht, Ai ka krijuar në çift, por nuk ka krijuar as edhe një binjak të ngjashëm me njëri-tjetrin në çdo gjë. Edhe binjakët prej një veze, duke filluar prej botës së tyre të brendshme, e deri tek gjurmët e gishtave apo sytë, kanë dallime të shumta nga njëri-tjetri...

Allahu i Madhëruar, të gjitha qeniet i ka krijuar në çift dhe midis tyre ka vendosur ligjin e tërheqjes



dhe joshjes, në sajë të të cilit ato krijojnë afërsi me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, plotësimin e tyre fizik dhe shpirtëror e ka lidhur në bashkimin me njëra-tjetrën.

Në kuadër të kësaj të vërtete, nevoja dhe prirja e një burri ndaj gruas dhe një gruaje ndaj burrit, esencialisht është për të siguruar vazhdimin e brezit. Por sigurisht që ky nuk është i vetmi qëllim, sepse edhe formimi i një strukture të fortë familjare dhe paqja, qetësia e harmonia shpirtërore e individit dhe shoqërisë, është një synim dhe një cak jash-tëzakonisht i rëndësishëm për njeriun. Dhe, arritja e kësaj paqeje, qetësie dhe harmonie të dëshiruar, realizohet vetëm në sajë të dashurisë ndaj Allahut. Pra, në sajë të orientimit të zemrës me ashk drejt Allahut të Madhëruar... Ky, është një udhëtim prej “Lejlës”³ drejtë Zotit...

Nëse mund të shprehemi kështu, për këtë udhëtim, Lejla është një kusht i domosdoshëm, sepse shkallën e parë të afrimit tek Allahu i Madhëruar me dashuri ndaj Tij, e përbën dashuria midis burrit dhe gruas. Edhe pse kjo dashuri fillon me dëshira trupore, pa i kaluar këto, ajo nuk mund të kthehet në “ashk”. Ashk, quhet tërheqja drejt njëra-tjetrës

3. Lejla: Në këtë kontekst, Lejla është personazhi i një historie dashurie klasike arabe “Lejla dhe Mexhnuni”.



së manifestimeve hyjnore që gjenden tek të dashuruarit.

Zemrat, që janë edhe qendra e kësaj force tërheqëse, trajnohen në sajë të bashkëshortëve që lidhen me dashuri ndaj njëri-tjetrit; pra, bëjnë ushtrime dashurie, duke u përgatitur për dashurinë ndaj Allahut. Në këtë mënyrë maturohet aftësia për të dashuruar Allahun. Ndërsa në sajë të fëmijës, që është fryti i natyrshëm i një familjeje, kjo aftësi piqet edhe më tepër dhe bëhet më e merituar.

Me qëllim që dashuria ndaj Allahut t'i mbështjellë zemrat me këtë aftësi, martesë duhet të realizohet duke u përshtatur me urdhrat hyjnore. Një martesë e cila realizohet vetëm me dëshirat, ambiciet dhe prirjet e mendjes dhe të trupit, në përgjithësi, nuk arrin ta vjelë frytin e dashurisë. Për rrjedhojë, në çerdhet që formohen në këtë mënyrë, nuk realizohet pjekuria shpirtërore dhe edukimi me dashuri i zemrës, të cilat priten prej një martese. Domethënë, zemrat nuk përfitojnë siç duhet, sepse në martesë të tilla, përgjithësisht njerëzit bëhen skllëvër të dëshirave egoiste. Dhe, jo vetëm që nuk përparohet në fushën shpirtërore, por bota e zemrës mbetet pas, thahet dhe shkon deri në degjenerim.

Martesat që bëhen shkak i pjekurisë dhe ngritjes shpirtërore, pra të cilat arrijnë të plotësojnë gjysmën



e fesë, shfaqin nivelin ideal që duhet arritur. Nëse diçka nuk është arritur plotësisht, nuk hiqet dorë nga pjesa e arritur. Po në të njëjtën mënyrë, gjithkush sipas mundësisë së vet nuk duhet të heqë dorë nga arritja e këtyre cilësive ideale. Vetëm në këtë mënyrë, mund të arrihet paqja, qetësia dhe pjekuria e dëshiruar prej martesës.

Megjithatë, lidhja midis gruas dhe burrit, nuk është e vetmja mundësi e njeriut për të fituar aftësinë dhe meritën në dashurinë ndaj Allahut. Nëse do të ishte kështu, të pamartuarit nuk do të shënonin asnjë përparim në pjekurinë shpirtërore dhe do të qëndronin vendnumëro. Në fakt, prej tyre ka shumë burra dhe gra të mira, si Merjemja⁴ dhe Isai (a.s.),

4. Në Kur'anin Fisnik, emri i Merjemes kalon 34 herë, ndërsa emri i Isait (a.s.), 23 herë. Përveç kësaj, surja e 19. e Kur'anit mban emrin "Merjeme". Merjemja, është e vetmja grua e cila përmendet me emrin e saj në Kur'an. Lidhur me këtë, komentuesit e Kur'anit kanë nxjerrë disa urtësi. Disa prej tyre janë si mëposhtë:

a. Imazhi i gruas së nëpërkëmbur në atë periudhë, është personifikuar tek nëna jonë Merjeme.

b. Përmendja e një peygamberi të madh (Ulu'l-azm), me emrin e nënës së tij (biri i Merjemes), është një tregues i madhështisë së nderit të nënës.

c. Duke u fokusuar veçanërisht në nderin e nënës sonë Merjeme, është theksuar qartë se sa detyrë e rëndësishme është ruajtja e nderit.

d. Tek Merjemja janë shprehur cilësitë më të spikatura të një gruaje të mirë. Pra, është theksuar se, tek një femër, cilësitë si nderi, maturia, durimi, mbështetja në Allahun, dorëzimi dhe qëndresa, e



të cilët i ka lavdëruar Kur'ani Fisnik. Kjo, tregon se jo të gjithë kanë të njëjtin brumë në përbërjen e natyrës së tyre të krijimit dhe se as faktorët e jashtëm të cilët ndikojnë tek ta nuk janë të njëjtë. Pra, në kuadër të programit të caktimit hyjnor, në kushtet e kësaj bote si një sprovë me përfitime të mëdha, për dikë, rruga e fatit dhe kësметit është e mbyllur, për dikë, janë caktuar disa pamundësi që e pengojnë martesën dhe për dikë tjetër, martesë është kthyer në një humbje dhe një vuajtje të madhe. Nëse bëjnë durim, këtyre robërve, Allahu i Madhëruar u fal disa aftësi, me ndihmën e të cilave mbase i arrijnë edhe më tepër dobitë që do të realizoheshin me anë të martesës. Për rrjedhojë, edhe pse kanë qenë të pamartuar, disa e kanë arritur këtë pjekuri dhe ngritje shpirtërore, duke treguar dashuri të madhe për gjallesat dhe bimët; dikush tjetër, duke treguar durim përballë fatkeqësive, sprovave, halleve dhe vuajtjeve, ka kapërcyer një nga një të gjitha shkallët për t'u ngritur tek Allahu i Madhëruar.

Për shembull, në epokën e lumturisë, edhe sahabët e sufës, të cilët nuk kishin mundësi për t'u martuar, kanë arritur majat e pjekurisë shpirtërore në sajë të shërbimit me diturinë dhe urtësinë e tyre. Natyrisht që këto janë raste të veçanta. E vërteta e përgjithshme dhe e domosdoshme, është që biri i



njeriut duhet të formojë patjetër një çerdhe të ngroh-të familjare me anë të aktit të nikahut.

Një gjë është e vërtetë, se një zemër ku nuk reflektohet dashuria, është si një tokë e lënë djerrë, ku nuk është mbjellë e nuk është korrur për një kohë të gjatë, pra, një tokë e braktisur. Lidhja dhe marrëdhënia midis gruas dhe burrit, do ta punojë këtë tokë. Natyrisht që kjo nuk duhet të bëhet me dëshirat të egos, por duke i eliminuar ato. Pra, orientimi i kësaj marrëdhënieje, është i detyruar të kthehet nga ashku hyjnor, sepse vetëm kur dashuria midis gruas dhe burrit merr cilësi hyjnore, atëherë edhe zemrat ngrihen në dashurinë ndaj Allahut.

Nëse në këtë pikë të pjekurisë bëhet kësmt ndonjë fëmijë, kjo përbën shkallën e dytë të zembrës në rrugën drejt dashurisë hyjnore. Pas kësaj, vjen shoku, miku, mësuesi etj. Në këtë mënyrë, duke përparuar shkallë shkallë, e hap pas hapi, zemra unifikohet e mbruhet me dashurinë hyjnore, që është edhe synimi më i lartë. Dhe më në fund, bëhet prej njerëzve fatlumë dhe të dashur të Allahut. Ja pra, ky përfundim, është edhe maja e qëllimit të krijimit të njeriut.

Shkurtimisht, familja, që është edhe emri fetar e shoqëror i bashkimit burrë-grua, është një fakt dhe një nevojë e cila është vendosur në natyrën e krijimit



tonë për të realizuar një qëllim kaq të lartë. Nëse ky qëllim realizohet, pema familjare lëshon degë, zhvillohet dhe jep fruta të bukur dhe të ëmbël. Dhe disa prej këtyre frutave, janë paqja, qetësia dhe rregulli social, të cilat dëshirohen nga e gjithë shoqëria.

Nga kjo pikëpamje, me qëllim që shoqëria të arrijë nivelin e civilizimit dhe që çerdhet familjare të mbushen me gëzim dhe lumturi hyjnore, në krye të çështjeve më të rëndësishme, duhet të jetë ambienti i qetë familjar. Për këtë arsye, kur formohet një familje, burri dhe gruaja i japin fjalën njëri-tjetrit në emër të Allahut. Kjo fjalë, është një synim dhe një përpjekje për të realizuar një dashuri në kuadër të qëllimit të krijimit të tyre. Dhe, ajo që do ta ushqejë këtë synim dhe përpjekje, duhet të jetë patjetër respekti, besimi dhe sinqeriteti reciprok.

Si e shikon Islami “familjen”?

Duke u nisur nga pikat e paneglizhueshme që numëruam më lartë, mund të themi se; Islami i jep një rëndësi shumë të madhe familjes. Në bazë të kësaj, familjet janë si farat e shoqërisë. Kjo, është një e vërtetë historike; familjet që ndërtohen mbi themele të forta, e ruajnë dhe e zbukurojnë struktu-



rën shoqërore. Mirëpo kur bashkëshortët nuk janë të barabartë në aspektin shpirtëror, për shkak të marrëdhënieve të këqija ose të ndërtimit të gabuar të çerdheve familjare, shkatërrohet edhe shoqëria.

Nga kjo pikëpamje, në sajë të dashurisë dhe kriterëve të të drejtave që ka vendosur, Islami ka ndërtuar një strukturë të ekuilibruar familjare. Pra, me familjen, ai synon paqen dhe lumturinë. Prandaj dhe është thënë:

“Xheneti i njeriut, është shtëpia...”

Me të vërtetë që, një çerdhe familjare e ndërtuar me kriteret hyjnore, është si një xhenet në kushtet e kësaj bote. Një botëkuptim dhe strukturë kaq madhështore, natyrisht që mund të realizohet vetëm mbi dashuri dhe kriterë të larta me themele legjitime. Prandaj, Islami i jep start kësaj çështjeje me një “aktmarrëveshje/dhënie reciproke të fjalës”. Pra, ai vendos kushtin që të dyja palët t’i japin fjalën njëri-tjetrit para Allahut. Në ndërtimin e një familje të lumtur dhe të qetë, nikahu ka një rëndësi dhe dobi shumë të madhe, sepse edhe vlera e punëve është sipas qëllimeve.

Bashkimet jashtëmartesore (pa nikah), të cilat realizohen pa u vënë në pah ky qëllim i lartë, për shkak se bien ndesh me qëllimin e krijimit të njeriut, edhe rezultati i tyre mund të kthehet në një dështim



dhe shkatërrim të plotë. Kjo, është një e vërtetë si në aspektin e strukturës familjare, ashtu edhe në aspektin e strukturës shoqërore. Për këtë arsye, bashkimet jashtëmartesore, janë të refuzuara fetarisht dhe dënimi i këtij akti tek Allahu, është jashtëzakonisht i rëndë, sepse ky akt është cilësuar si një gjynah dhe një haram i madh dhe i rrezikshëm.

Nisur nga rëndësia e madhe që ka, a mund ta shpjegoni edhe pak më shumë çështjen e nikahut?

Nikahu, është rruga e pejgamberëve, suneti i Resulullahut, pranvera e brezave, dinjiteti dhe edukata e mashkullit dhe e femrës, kalaja e namusit dhe nderit dhe veçoria dalluese e njeriut nga krijesat e tjera, pra superioriteti i tij.

Realizimi i nikahut me dy dëshmitarë meshkuj, është një faktor themelor në legjitimimin shoqëror të bashkimit burrë-grua, sepse në këtë mënyrë njoftohet edhe pjesa tjetër e shoqërisë, gjë që është një nevojë e domosdoshme. Jo çdolloj përcaktim-qëllimi ka nevojë për dëshmitarë, por vendosja e kushtit të dëshmitarëve në martesë, është për shkak që e gjithë shoqëria ta njohë dhe pranojë këtë akt martesë. Kjo, sepse një djali apo një vajze që dihet se janë



beqarë, gjithmonë është e mundur t'u vijnë kërkesa të reja. Mirëpo, kur një martesë bëhet e ditur duke shpallur aktin e nikahut, atëherë ndërpriten edhe kërkesat e mundshme për atë djalë apo vajzë. Në këtë mënyrë, hidhen edhe themelet e një çerdheje të shëndoshë familjare, ku dy bashkëshortët i takojnë vetëm njëri-tjetrit.

Nga një pikëpamje, kur nuk mjaftohet me dy dëshmitarë, atëherë bëhet një dasmë, në sajë të së cilës e gjithë shoqëria bëhet dëshmitare e këtij akti martesor. Për rrjedhojë, dasmat nuk kanë lindur vetëm për të ndarë me të tjerët kënaqësinë e formimit të një çerdheje familjare, por në të njëjtën kohë, edhe për shkak të nevojës së njoftimit të shoqërisë në lidhje me nikahun.

Në fakt, nikahu me të gjitha veçoritë e tij, është një ligj hyjnor që është urdhëruar për të ruajtur strukturën dhe ndjenjat e larta të natyrshmërisë së krijimit të njeriut. Për rrjedhojë, sipas Islamit, nikahu është një themel familjar madhështor dhe i pazëvendësueshëm në aspektin e vazhdimit të brezave, të edukimit të fëmijës, të mbrojtjes së familjes dhe të ruajtjes së ndjenjave njerëzore.

Islami i jep një rëndësi aq të madhe këtij themeli, saqë i refuzon plotësisht marrëdhëniet e prishura dhe të mjera, të cilat e shkatërrojnë atë. Nisur nga



kjo, veprën e “**zina**”-së⁵, që është edhe akti më i keq i poshtërsive jashtëmartesore, e ka ndaluar në cilësinë e një harami shumë të madh. Kjo vepër e keqe, është një sulm i çmendur ndaj delikatesës, bukurisë dhe legjitimitetit të nikahut; ajo është një vrasje e pamëshirshme e cila mund të zhdukë një brez të tërë. Nuk mund të ketë mendjelehtësi dhe injorancë më të madhe se sa të ndërrosh botën e një lumturie dhe qetësie madhështore si nikahu, me një ndyrësi si kurvëria.

Rrugicat e një populli dhe një atdheu me virtyte të larta, nuk mund të bëhen skena të paturpësive. Sheshet, nuk janë vende ku përzihet amoraliteti.

Nuk duhet harruar se, elementi më themelor që e mban në këmbë një popull, është struktura fetare dhe morale. Dhe, mënyra më efikase e formimit dhe mbrojtjes së një strukture të tillë, është nikahu. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), duke e porositur umetin e tij në lidhje me lehtësimin e tij, thotë:

“Nikahu më i mirë, është ai më i thjeshti.”

(Ebu Daud, Nikah, 32)

Për rrjedhojë, mund të themi se, zakonet që e vështirësojnë nikahun, duke kërkuar shpenzime të tepërta, janë zbatime të padobishme, të cilat i

5. **Zina:** Marrëdhënie seksuale jashtëmartesore.



vonojnë martesat ose i bëjnë ato të pamundura.

Allahu i Madhëruar, dëshiron që robi të jetojë me nder dhe në paqe. Dhe gjëja më e bukur që siguron nderin, është martesa. Ashtu siç duhet të martohen ata që kanë mundësi të martohen, ashtu edhe martesa e atyre që nuk kanë mundësi, është një detyrë fetare që i është ngarkuar shoqërisë islame. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju! Po ashtu edhe skllëverit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm! Nëse janë të varfër, Allahu do t’i begatojë ata me mirësinë e Tij; Allahu është i Gjerë në mirësi dhe i Gjithëdijshëm.” (Nur, 32)

Në periudhën e Perandorisë Osmane, janë ngritur vakëfe të posaçme për të kryer këtë shërbim të lartë, sepse rregulli dhe morali i shoqërisë, janë të lidhur fort me jetën e ndershme dhe të qetë të individëve.

Muhyiddin Arabiu -Allahu e mëshiroftë-, në lidhje me virtytin e nxitjes së martesës dhe ndihmesës së të martuarve, thotë:

“Sadakaja xharije⁶ më e mirë, është të bëhesh



shkak i një martese, sepse njeriu fiton shpërblime prej çdo mirësie që do të bëjnë ata që do të lindin prej asaj martese.”

Jeta familjare që filloi në xhenet me babanë tonë Ademin (a.s.) dhe nënën tonë Hava, është përcuar tek bijtë e Ademit me anë të ligjit të martesës që caktoi Allahu dhe është përjetësuar me fenë Islame. Dhe me të vërtetë që, me rregullat që ka vendosur feja Islame, është bërë një paqe xheneti dhe një qiell mëshire i një pranvere të vazhdueshme për jetën familjare. Për të arritur këtë lumturi, është e domosdoshme të shfaqësh tablonë e një Ademi dhe Havaje me ligjin e nikahut, të shkrihesh në rrugën e dashurisë dhe devotshmërisë ndaj Allahut dhe të bëhesh një shpirt dhe një frymë si ata.

Në bashkimin e mrekullueshëm të dy personave të panjohur me anë të nikahut, fshihen mësimet dhe urtësi të holla që i mahnitin mendjet. Lidhja e zemrave të dy të rinjve të panjohur të cilët janë ndarë nga shtëpia e prindërve, me dashurinë dhe mëshirën që ka falur Allahu midis tyre, madje të jetojnë me një sinqeritet të ngrohtë dhe joshës, aq sa të lënë në hije edhe çerdhen e prindërve prej të cilëve janë ndarë, është manifestimi i një urtësie

etj., prej të cilave do të kenë dobi njerëzit dhe krijesat e tjera edhe pas vdekjes së personit.



shumë madhështore. Është një mësim i shenjtë mbi të cilin duhet medituar thellë-thellë.

Allahu i Madhëruar, e ka bërë nikahun shkak të begatisë mbi umetin e Muhammedit (a.s.). Martesën nën hijen e Kur'anit dhe Sunetit e ka bërë lumturinë e xhenetit për jetën e kësaj bote.

Feja Islame, e cila dëshiron t'i japë njerëzimit një jetë me harmoni dhe nder, i ka dhënë gruas vlerën më të madhe dhe e ka mbrojtur atë nga dëmet që lindin prej neglizhencës ndaj saj. Gruaja, është si një llambë e kristaltë e varur në tavanin e lumturisë dhe paqes familjare. Ajo e ndriçon shoqërinë me frymëzimin dhe dritën e nikahut. Ajo e mbron nderin dhe namusin e familjes. Nëse është e vendit ta themi, ajo duhet të jetë si një rrufepritëse e familjes kundër vorbullave dhe erozioneve të gjynaheve. Përndryshe, brezat do të humbin dhe njerëzimi do të kthehet në një gërmadhë. Humbja e brezit, çon në anulimin e lidhjeve farefisnore, gjë e cila të shpie deri në shkatërrimin e shoqërisë. Në këtë mënyrë, kaosi bëhet si akrep. Ndjenjave të holla e delikate u vjen fundi. Ndërsa poshtërsitë dhe trazirat arrijnë kulmin. Dhe këto, janë treguesit e perëndimit dhe alarmet e shkatërrimit të një shoqërie.

Lumturia e grave, është e mundur kur ato jetojnë si zonja fisnike. Nëse gruaja shkon jashtë detyrës



së saj të vërtetë, ajo e çon familjen drejt dështimit. Pjesëmarrja e gruas në çështjet e jashtme, mund të bëhet vetëm për shkaqe të detyrueshme dhe për punë që përshtaten me natyrën e saj. Por, këto shkaqe të detyrueshme duhen vlerësuar në mënyrë objektive. Pra, duhen përcaktuar në bazë të nevojave të shoqërisë dhe nuk duhen kaluar kufijtë e pranueshëm e legjitim.

Kufijtë e shkelur me arsye dhe dëshira të kota, janë vetëm mashtrim i vetvetes, rezultati i të cilave del gjithmonë me humbje. Në këtë mënyrë, edhe shumë prej bijave tona kanë humbur në vorbullën e shkujdesjes së fundkohës. Shumë sy të mashtruar prej bukurisë, e cila ka mbuluar paturpësinë, janë verbuar ndaj të vërtetave hyjnore dhe kanë shkatërruar lumturinë e vetvetes.

Duhet ditur se, në syrin e Islamit, gratë janë një eliksir jete që shpërndajnë rreze drite brenda llambës së kristalit të nikahut. Identiteti dhe madhështia morale, shoqërore dhe kombëtare e gruas, gjendet vetëm në jetesën brenda kuadrit shpirtëror të nikahut. Në sajë të çerdhes së formuar me nikah, gruaja hyn në një botë krejt të re. Ajo fillon të jetojë me një burrë dhe pjesëtarët e tjerë të familjes së tij, të cilët mbase nuk i ka njohur kurrë më parë. Mirëpo, ekziston një cilësi e veçantë që Allahut i ka falur



martesës. Kjo, është që kur çifti i cili bashkohet në sajë të nikahut, bëhen dy njerëzit më të afërt në botë për njëri-tjetrin ndërkohë që më parë ishin vetëm dy të huaj. Tashmë, çerdhja që kanë ndërtuar, në të shumtën e rasteve ju bëhet më e ngrohtë nga shtëpia e babait prej së cilës janë ndarë. Allahu i Madhëruar shprehet:

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.” (Rum, 21)

Atëherë, elementi i vetëm mbizotërues për lumturinë në familje, duhet të jetë dashuria midis bashkëshortëve, singëriteti dhe butësia.

Kjo lumturi, është e pamundur të arrihet në çdo çerdhe familjare. Atëherë, arritja e kësaj lumturie dhe paqeje duhet të jetë një mirësi shumë e madhe... Çfarë duhet të kemi kujdes në këtë çështje?



ka vendosur Islami për zgjedhjen e bashkëshortëve. Thelbi i këtyre rregullave është ky: Ata që dëshirojnë të martohen, nuk duhet t'i zgjedhin bashkëshortët në bazë kriterëve të përkohshme të cilat i pëlqejnë egos njerëzore, si bukuria, pasuria etj. Por duhet bërë një zgjedhje ku i jepet më tepër rëndësi cilësive shpirtërore, si besimi dhe morali. Lidhur me këtë, Pejgamberi (a.s.), është shprehur:

“Gruaja martohet (zgjidhet) për katër gjëra: për pasurinë, bukurinë, sojin dhe besimin e saj. Zgjidhni atë që është besimtare, që të keni mirësi!..” (Buhari, Nikah, VI. 123; Muslim, Radâ, 53)

Duke u nisur nga fakti se, çerdhen e bën zogu femër, ky hadith fisnik në të cilin theksohen cilësitë që duhet të kërkohen tek një grua me të cilën do martohet, përfshin edhe cilësitë që duhen kërkuar tek një burrë me të cilin do martohet. Kjo, sepse për çdo besimtar, mirësia më e madhe pas devotshmërisë, është që edhe njeriu me të cilin do të martohet, të jetë vepërmirë. Burri i mirë, është shtylla e palëkundshme e sarajit të paqes; ndërsa gruaja e mirë, është zbukurimi më i çmuar i kopshteve të lumturisë.

Gjithashtu, edhe balanca midis familjeve duhet pasur parasysh. Kjo balancë, duhet përcaktuar duke marrë parasysh elemente të ndryshëm si pasurinë, traditën dhe kulturën e përbashkët.



Pas kësaj, çdo gjë varet nga vullneti dhe pjekuria. Pjekuria, është përsosmëria e besimit dhe e veprave; ndërsa vullneti realizohet në sajë të kapjes fort pas urdhrave dhe ndalesave të Islamit.

Një çerdhe e qetë familjare brenda së cilës respektohen urdhrat dhe ndalesat e Allahut, është themeli i lumturisë së kësaj bote dhe një nga mirësitë më të mëdha të Zotit tonë. Vazhdimësia e kësaj mirësie dhe lumturie, arrihet me jetesën e të dyja palëve brenda një atmosfere shpirtërore, gjë e cila varet nga sakrificat dhe mirëkuptimi reciprok.

Në krye të shkaqeve më të rëndësishme të erozionit që po pëson familja në ditët e sotme, vjen fakti se, **“gruaja po bëhet si burrë dhe burri si grua”**. Allahu i Madhëruar, burrin e ka pajisur me cilësi të ndryshme nga ato të gruas. Këto cilësi, janë formuluar në mënyrë të tillë, që të dy të kryejnë ashtu siç duhet detyrat e tyre në shoqëri. Të gjitha cilësitë natyrore të burrit dhe gruas, që prej strukturës trupore e deri tek veçoritë shpirtërore, janë krijuar sipas përgjegjësive që Allahu i Madhëruar i ka ngarkuar atyre të dyve. Kjo, duket në cilësitë, si qëndrueshmëria shpirtërore, rezistenca dhe veçoritë trupore të burrit, i cili është ngarkuar me detyrën e sigurimit të jetesës së familjes. Për rrjedhojë, kjo kërkon që burri të marrë përgjegjësinë e kryerje së detyrës së kryetarit të familjes dhe të sigurojë jetesën



e asaj familjeje duke bërë edhe të pamundurën.

Gruaja, nuk është ngarkuar me përgjegjësinë e sigurimit të jetesës së familjes. Nëse do të ishte ngarkuar me këtë përgjegjësi, kjo do të ishte vuajtje dhe torturë për të, sepse në aspektin shpirtëror dhe trupor, natyra e saj nuk është e përshtatshme të punojë për të siguruar jetesën. Pikësëpari, duke pasur parasysh periudhat e dobësisë së tyre gjatë dhe pas lindjes së fëmijëve që do të vijnë prej këtij bashkimi, ato kërkojnë kujdes dhe mbrojtje, sepse atyre iu është ngarkuar një detyrë hyjnore që kërkon ndjenja të thella. Mirëpo, nëse jepet mundësia, ato mund të punojnë në një profesion të ligjshëm dhe të përshtatshëm për natyrën e tyre femërore.

Të gjitha këto cilësi natyrore që janë vepër e përcaktimit hyjnor, i falin gruas dhe burrit një identitet të veçantë dhe plotësues të njëri-tjetrit. Dhe, nëse bashkëshortët dalin jashtë këtyre cilësive, atëherë dëmtohet edhe lumturia familjare.

Gjithashtu, na duhet të përmendim çështjen se; autoriteti i burrit në familje, nuk duhet kuptuar në formën e “tiranisë” (sundim me forcë). Kurse bindja e gruas, nuk duhet kuptuar si “robëri”. Nëse këto role realizohen brenda kriterëve të mirësjelljes, ashtu siç i ka caktuar Islami, në familje nuk do të ketë as “shtypës” dhe as “të shtypur”...



Nëse gruaja del jashtë rrethit të nderit dhe bindjes, duke i bërë padrejtësi burrit të saj, ose e kundërta, nëse burri e përdor autoritetin e tij për të arritur dëshirat e egos së tij, çerdhja familjare do të pësojë dëme shumë të mëdha. Mirëpo, burri, i cili ka për detyrë të luftojë për të siguruar jetesën në botën e jashtme, shpesh mund të bëhet subjekt i tensioneve dhe streseve. Për këtë arsye, është edhe drejta, por edhe nevoja e tij, që në momente të tilla të shohë prej gruas së tij një bindje qetësuese të shoqëruar me butësi dhe dashuri. Në të njëjtën mënyrë, edhe gruaja që e pret burrin e saj në shtëpi deri në mbrëmje, ka të drejtë dhe nevojë të shohë kujdes dhe interesin e duhur prej burrit të saj. Kjo është edhe arsyeja që, në familje të gjithë duhet t'i dinë të drejtat dhe përgjegjësitë që u ka caktuar Allahu. Në një familje, burri duhet të jetë i mëshirshëm dhe i drejtë, ndërsa gruaja e bindur dhe e respektueshme.

Në fakt, rregulli i vetëm që e bën një familje të jetojë në paqe dhe lumturi, është dashuria dhe respekti reciprok. Por, nuk duhet harruar se, të parët tanë kanë një shprehje: “Çerdhen e ndërton zogu femër”. Dhe, duke u nisur nga kjo, në lidhje me kujdesin ndaj çerdhes, gruaja ka marrë përsipër një rol më efektiv. Për rrjedhojë, intuita, përpjekja dhe sakrifica që duhet të tregojë gruaja në këtë pikë, ka një rëndësi më të madhe se ajo e burrit. Kjo, sepse



në këtë pikë, Allahu i Madhëruar i ka falur nënës aftësi dhe ndjenja më superiore se ato të burrit.

Në këtë kuadër, edhe i nderuari Ismail Hakki Bursevi, në shpjegimin e fjalës “*et-teraib*”, e cila kalon në ajetit 7. të sures *et-Tarik*, shprehet:

“Nëse një fëmijë bie në lumë, sado e rrezikshme të jetë, nëna e hedh veten e saj në lumë dhe jep edhe jetën për të shpëtuar të voglin e saj. Mirëpo, babai nuk sillet në të njëjtën mënyrë. Nëse i ka prerë shpresat për atë fëmijë, ai qëndron në breg të lumit duke qarë i hidhëruar.”

Sigurisht që, ndjenja të tilla i bartin vetëm ato nëna të cilat nuk i kanë humbur aftësitë madhështore të natyrës që u ka falur Allahut. Në fakt, ka edhe nga ato nëna mizore e të pashpirta që i braktisin fëmijët e tyre nëpër vende kulturi ose në varreza⁷. Mirëpo këta janë shpirta gërmadhë, të cilët i kanë vrarë e zhdukur aftësitë madhështore që u ka falur Allahu.

Në kushte normale, ndjenja amënore nuk mund ta cenojë në asnjë mënyrë një fëmijë. Kjo ndjenjë

7. Në përgjithësi, në vendet me shumicë myslimane si Turqia, fëmijët që braktisen nga prindërit, lihen nëpër xhamia apo në varreza, ashtu siç lihen edhe në vendet të tjera me kulturë të krishterë në kisha ose manastire. Ndërsa në vendin tonë, sipas statistikave, fëmijët më tepër braktisen nëpër spitale ose jetimore.



e lartë, është një e vërtetë që dëshmohet edhe tek kafshët. Një shembull mësimdhënës i cili u evidentua gjatë xhirimit të një dokumentari, e nxjerr qartësisht në pah këtë të vërtetë:

Në Parkun Natyror Samburu në Kenja, midis datave 21 Dhjetor 2001 dhe 1-2 Janar 2002, një nënë luaneshë dhe një këlysh drenushe krijojnë një marrëdhënie jashtëzakonisht të mahnitshme nënë-fëmijë. Kur u shfaq për herë të parë në kamera, i vogli i drenushës bartte ende kordonin e kërthizës. Siç duket, nënës luaneshë i është dhimbsur dhe në një farë mënyre e ka birësuar të voglin e drenushës. Dhe për shkak të kujdesit të madh që tregon nëna luaneshë për të, i vogli nuk ndahet aspak prej saj. Për arsye se nuk mund të pijë qumësht, i vogli mundohet të ushqehet me gjethe. Ndërsa nëna luaneshë, është e vetëdijshme se ai është një këlysh drenushe, sepse nuk mundohet fare që ta ushqejë me mish. Madje, gjatë kësaj kohe, edhe pse është dobësuar shumë, luanesha nuk del as për gjah. E megjithatë, të dy janë të shëndetshëm. Pra, edhe pse janë të dobët, për shkak se i vogli nuk mund të pijë qumësht dhe luanesha për shkak se nuk mund të gjuajë, sjelljet e tyre janë plot gjallëri.



të voglin nën mbrojtjen e luaneshës. Mirëpo, as nuk mund t'i afrohet dhe as nuk mund të largohet prej aty. Më pas nxjerr disa zëra prej së largu dhe komunikon me të voglin e saj. Në këtë mënyrë ajo krijon një lidhje me të voglin e saj. Madje fillojnë edhe të kullotin së bashku. Mirëpo, të gjitha këto ndodhin në kontrollin e nënës luaneshë, sepse ajo e ka përvetësuar plotësisht të voglin e drenushës dhe është mësuar me të. Për këtë arsye, ajo nuk dëshiron që i vogli të ndahet prej saj. Në fakt, ajo nuk bën zë përderisa i vogli shëtit me nënë e tij pa shkuar shumë larg. Por, nëse i vogli largohet shumë, atëherë ajo ndërhy, sepse e do shumë të voglin e drenushës. Aq, sa e përkëdhel me gjuhë, i lëpin veshët dhe luan duke i fërkuar kokën me faqet e saj. Megjithatë, më në fund nëna luaneshë e ndjen se i vogli i përket nënës drenushë. Prandaj, duke i marrë erë, duke e përkëdhelur dhe duke u fërkuar me të, ndahet e hidhëruar me të voglin e drenushës. Mirëpo, ndërkohë që i vogli qëndronte vetëm për vetëm me nënë e tij, një luan mashkull i pikas dhe menjëherë e kap këlyshin e dobët e të pambrojtur. Nëna luaneshë e sheh këtë skenë dhe preket jashtë mase. Pastaj shkon në vendin ku dergjej trupi i të voglit, i merr erë gjakut dhe ul kokën, duke derdhur lot brenda vetes.

Kjo ndodhi e pasqyruar nga kamerat, është një



shembull i mahnitshëm hyjnor. Këtu shohim se sa madhështore është ndjesia amënore. Gjithashtu, kuptojmë se kjo ndjesi mund të dalë në pah edhe midis dy lloje kafshësh që si natyrë janë armiq të njëri-tjetrit. Ja pra, kjo është një prej argumenteve madhështore të Allahut të Madhëruar. Një mrekulli hyjnore e cila manifestohet në fushën e amësisë.

Këtu ka shumë urtësi dhe mësim për ne. Pra, nëna, është nënë në sajë të aftësive të saj të larta shpirtërore dhe jo vetëm në sajë të cilësive të saj fizike. Nëse një grua i jep lamtumirën këtyre, pra të qenit grua dhe nënë, tashmë nuk mund të jetë më një monument dhembshurie, por një gjahtar pandjenja që i merr në qafë fëmijët e saj. Për këtë arsye, pa pësuar asnjë humbje prej thesarit të mëmësisë, gratë duhet ta ruajnë atë në një nivel më të lartë se sa krijesat e tjera. Kjo, sepse për krijesat e tjera, nuk ka përballje me të vegjlit e tyre në Ditën e Gjykimit dhe dhënie llogarie për ta. Mirëpo për njerëzit ka. Pra, për njerëzit, fëmijët e tyre do të dalin përballë me ta në Ditën e Gjykimit ose për mirë ose për keq. Nisur nga kjo, mëmësia më e mirë dhe më e lartë që mund të tregohet ndaj të vegjëlve, është t'i edukosh ata në një formë që do t'i ruajë nga zjarri i xhehenemit dhe t'u japësh një botëkuptim jetësor që do t'u bëhet shkak i fitimit të xhenetit. Për këtë arsye, edukimi fetar dhe edukata e bukur, pra edu-



kata morale dhe vetëdija e devotshmërisë, vijnë në krye të atyre që duhet t'u jepen.

I nderuar, në shoqërinë tonë, personat që do të martohen kalojnë një periudhë që quhet fejesë. Gjatë kësaj periudhe përjetohen shumë probleme. Cilat janë çështjet që duhet të kenë kujdes të dyja palët në periudhën e fejesës?

Ajo që u përpoqëm të shpjegojmë deri tani, ishte çështja e ndërtimit të familjes me një strukturë të shëndetshme dhe të palëkundshme. Për rrjedhojë, për të ndërtuar familjen mbi themele të rregullta e të drejta, duhet të veprohet brenda kriterëve hyjnore, jo vetëm në periudhën e fejesës, por në çdo periudhë që nga fillimi deri në fund. Mirëpo në kohën tonë, disa njerëz, në periudhën e fejesës sillen sikur janë të martuar. Për këtë arsye, bëhen shumë gabime dhe shkaktohen plagë zemre të pariparueshme.

Duhet shprehur se, faza e prerjes së fjalës dhe e fejesës, nënkupton fazën ku të dyja palët marrin vendime dhe bien dakord në rrugën e martesës. Pra, kjo fazë, nuk është si faza e nikahut (martesës). Të dyja palët janë ende të huaja për njëri-tjetrin. Kjo,



do të thotë se muri i ndalesave midis tyre nuk është hequr ende. Për rrjedhojë, duhet pasur shumë kujdes ndaj kufirit të haramit dhe hallallit.

Shkurtimisht, për dy të fejuar që nuk e kanë bërë ende nikahun, është e papranueshme të qëndrojnë vetëm për vetëm në vende të mbyllura dhe të flasin më tepër seç duhet me njëri-tjetrin. Në ditët e sotme, të gjithë po i dëshmojmë pasojat e këqija të këtyre sjelljeve.

I nderuar, çfarë mund të na thoni në lidhje me dasmën?

Dasma në martesë, është një shkak për të ndarë gëzimin dhe lumturinë me miqtë dhe të afërmit. Në të njëjtën kohë, dasma bëhet edhe për të realizuar parimin e shpalljes së nikahut në mes të të gjithëve. Po ashtu, ajo është qëllimi i mirë për ta kthyer në një shkak gëzimi e lumturie një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, siç është ndërtimi i një çerdheje familjare për të siguruar vazhdimin e brezave. Kjo, është një domosdoshmëri e krijimit tonë.

Mirëpo, duhet theksuar se, të bësh dasma me shpenzime të mëdha, të cilat bëhen shkak rrënimi për familjet, është diçka që Islami nuk mund ta pranojë



kurrë. Kjo, sepse Islami urdhëron të bëhet kujdes të mos shpërdorohet uji edhe kur merret abdest në një lum që rrjedh dhe, kërkon të mësohemi të veprojmë me maturi dhe përmbajtje. Për rrjedhojë, edhe nëse familjet janë të pasura, ato duhet të veprojnë duke zgjedhur rrugën e mesme dhe duke menduar për nevojtarët dhe të mjerët që jetojnë në shoqëri. Në ditët tona shumë të pasur (myslimanë) i bëjnë dasmat madhështore, duke dashur të tregojnë pasurinë e tyre të madhe, gjë e cila i shpie në çmendurinë e shpërdorimit. Por, të gjitha këto tregojnë se ata nuk e kanë përvetësuar ashtu siç duhet Islamin.

Në fakt, dasmat duhet të bëhen me hijeshi dhe modesti, duke qëndruar larg prej çdolloy dukje për mburrje dhe luks. Të gjithë duhet të bëjnë një ceremoni modeste sipas mundësive të tyre financiare. Luksi i tepërt material me qëllim për t'u mburrur, e shkatërron qëllimin dhe frymën shpirtërore të dasmës. Sidomos, kur në to bëhen disa veprime dhe zakone të gabuara të cilat bien ndesh me kriteret hyjnore, ato bëhen shkak që një rrugë e bekuar si martesë, të fillojë me hapa të gabuar, duke devijuar në injorancë dhe humbje. Ndërsa ceremonitë dhe gostitë martesore që përshtaten me ligjet e Allahut të Madhëruar dhe rregullat e moralit, janë vende të bekuara në të cilat pranohet edhe duaja.



Megjithatë, me kusht që të mos përzihen burra dhe gra bashkë, janë lejuar argëtimet hallall që bëhen midis grave më vete dhe burrave më vete.

Nga ana tjetër, në gostinë që do të bëhet, pra në atë që konsiderohet një gosti xheneti dhe që është një sunet i fortë i Pejgamberit (a.s.), duhet të thirren edhe nevojtarët dhe të vetmuarit. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka paralajmëruar në këtë mënyrë:

“Sa gosti e keqe është gostia e asaj dasme ku thirren të pasurit dhe nuk thirren të varfrit.” (Buhari, Nikah 72; Muslim, Nikah 107. shih. Ibn-i Maxhe, Nikah 25)

Duhet ditur se, populli ndihmohet në sajë të duave të të dobëtëve. Për rrjedhojë, në gosti duhet të ftohen veçanërisht të varfrit dhe të vetmuarit. Duhet të kujtojmë edhe fjalët e Musait (a.s.), kur e pyeti Allahun e Madhëruar:

“- O Zot! Ku të kërkoj Ty?” Allahu iu përgjigj:

“- Më kërko pranë zemërthyerve!” (Ebu Nuajm, Hilje, II, 364)

Kjo, tregon se përgjërimet dhe lutjet e zemërthyerve dhe të vetmuarve, janë të pranueshme tek Allahu. Për këtë arsye, duhet bërë përpjekje për të marrë duatë e tyre. Dhe, në mënyrë të veçantë në momentet e rëndësishme si martesë, kur hidhen the-



melet e një familjeje. Gjithashtu, nuk duhet lënë pas dore edhe marrja e duave prej njerëzve të mirë.

I nderuar, cilat janë çështjet që duhet të kenë kujdes të rinjtë e martuar në aspektin e shëndetit të çerdhes familjare?

Duhet ditur mirë se; popujt ngrihet në sajë të burrave, por këtë ngritje e plotësojnë gratë. Ashtu siç nuk mund të ketë përparim pa burrin, ashtu nuk mund të ketë ngritje dhe përparim pa gratë. Edhe nëse ka, ajo do të ngelet e mangët. Kjo lidhje, është edhe shkaku që në të shumtën rasteve, burri që nuk është i qetë në familje, nuk është i suksesshëm as në punën e tij. Për këtë arsye, mund të themi se, atdheu, zhvillohet në sajë të pjekurisë dhe edukimit të gruas. Ndërsa, si rezultat i uljes së gruas, edhe atdheu edhe kombi e humbin vlerën dhe fuqinë e tyre. Faqet e historisë, janë të mbushura me shembuj të kësaj të vërtete. Ja pra, për këtë arsye nevoja për struktura të shëndetshme familjare, është jash-tëzakonisht e domosdoshme.

Në aspektin e krijimit, njeriu është një qenie e përsosur. Mirëpo, karakteri dhe identiteti ku do të pasqyrohet kjo përsosmëri, shfaqet në një çerdhe të



shëndoshë familjare. Për rrjedhojë, çerdhja familjare, për njeriun duhet të jetë realizuese e ndjenjës së mirësisë dhe gjiri më i ngrohtë i edukimit të sjelljeve. Nëse arrihet kjo, zemrat fitojnë një nivel të lartë shpirtëror, duke marrë hise prej jetës familjare të pejgamberëve dhe njerëzve të dashur të Allahut. Në këtë kuadër, mund të themi se; lumturia familjare, varet nga respektimi reciprok i të drejtave të të dyja palëve dhe përforcimi i këtij respekti me anë të dashurisë.

Në lidhje me çështjen e realizimit të lumturisë familjare, është shumë e rëndësishme të përfitosh prej burimit të “takvasë/devotshmërisë” të cilin ka për qëllim edhe shprehja në ajetin: **“ittekullah/Kini frikë Allahun!”**⁸. Qielli dhe toka janë dëshmitarë se, kjo botë në sajë të respektimit të të drejtave të grave është bërë xhenet, ndërsa si pasojë e mosrespektimit të tyre është kthyer në xhehenem. Pejgamberi (a.s.), në një pjesë të Hutbes së Lamtumirës, në lidhje me gratë ka thënë:

“O njerëz! Respektojini të drejtat e grave! Silluni butë dhe me dashuri ndaj tyre! Ju këshilloj të keni frikë Allahun në lidhje me to. Ju i keni marrë gratë si një amanet i Allahut. Ndërsa nderi dhe namusi i tyre u është besuar juve pasi keni



dhënë fjalën në emër të Allahut!” (Sahihi Buhari, Muhtasar, X. 398.)

Nisur nga kjo, t'i shkëpusësh gratë nga angazhimi me edukimin moral të fëmijëve të tyre për të siguruar një brez të shëndetshëm, duke i orientuar ato drejt punëve që bien ndesh me natyrën madhështore të krijimit të tyre, nuk është pjesë as e logjikës, as e inteligjencës dhe as e besimit. Nuk bën pjesë, sepse paqja dhe lumturia në familje, është një mirësi e cila arrihet vetëm me ruajtjen dhe përdorimin në vendin e duhur të cilësive dhe aftësive që gjenden tek gruaja dhe burri.

Martesa e cila bëhet për të arritur këtë mirësi, është një strukturë mbi të cilën Islami mban një qëndrim jashtëzakonisht delikat. Ajo përbëhet nga dy anë; nga ana shpirtërore dhe materiale. Për rrjedhojë, për ta ndërtuar çerdhen familjare mbi dy kahe, është kusht që të jesh jashtëzakonisht serioz dhe i kujdesshëm. Në të kundërtën, martesa mund të kuptohet sikur të jetë diçka shumë e thjeshtë. Dhe, çerdhet familjare që ndërtohen me një botëkuptim kaq të cekët, për fat të keq përfundojnë me ndarje të panevojshme. Me të vërtetë që, fundi i bashkëshortëve që nuk bashkohen me ndjenja fetare dhe morale, është ose ndarja, ose një zinxhir vuajtjesh i cili shtrihet deri në varr. Natyrisht që, ky nuk është



aspak një përfundim i dëshiruar. Kjo është edhe arsyeja që divorcet janë vlerësuar si një fenomen që e tronditin Arshin e Allahut. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Martohuni, mos u ndani!.. sepse për shkak të ndarjes tronditet Arshi...” (Ali el-Muttaki, IX, 1161/27874)

Sidomos ndarja e gruas për kënaqësi dhe qejf, është një krim e mizori, që edhe llogarinë, edhe dënimin e ka të madh dhe, nuk është aspak e lejuar/hallall. Kjo është një shkelje e të drejtës së robit, të cilën Allahu nuk mund ta falë në asnjë mënyrë. Kjo, do të thotë ta hedhësh veten në shkatërrim e humbje.

Martetat që bëhen ashtu për qejf dhe pame-nduar dhe ndarjet e paevitueshme që vijnë pas tyre, kanë përfundime aq të hidhura, sa nuk mund të numërohen. Pasojat më të rënda dhe më të këqija reflektohen në mënyrë të veçantë tek fëmijët. Fëmijët që nuk e gjejnë ngrohtësinë brenda familjes dhe bëhen subjekt i sjelljeve të këqija të prindërve të tyre prej të cilëve duhet të marrin shembull, jetojnë të braktisur në mëshirë të rrugëve. Kur gjendja është e tillë, këta fëmijë që largohen nga shtëpia dhe bëhen pjesë e fëmijëve të rrugës, brenda një kohe të shkurtër bien në rrjetën e duhanit, alkoolit,



drogës, prostitucionit dhe organizatave të ndryshme kriminale. Dhe kjo, i përgatit themelet një fatkeqësie që do të shkatërrojë gjithë shoqërinë. Gjithashtu, kjo bëhet shkaktare e një erozioni të frikshëm moral që e shkreton jetën shoqërore.

Megjithatë, është e natyrshme të theksojmë edhe një të vërtetë tjetër në lidhje me divorcin. Sipas Islamit, akti i nikahut, nuk është “një akt që nuk mund të priset në asnjë mënyrë dhe që duhet të vazhdojë një jetë të tërë në mënyrë të pashpresë”, siç ndodh tek të krishterët katolikë. Për shkak se çdo marrëveshje është një vepër e atyre që e bëjnë këtë marrëveshje, si pasojë e disa kushteve të detyrueshme, natyrisht që ajo mund edhe të anulohet me anë të një marrëveshjeje të re që mund të bëhet midis dy palëve. Ky, është një rregull i përvetësuar nga Islami, të cilin e kërkon edhe mendja, edhe logjika e shëndoshë. Përndryshe, nëse nuk ekziston e drejta e ndarjes në një martesë të gabuar e të papërshtatshme, jeta i bëhet helm njeriut dhe ajo martesë kthehet në një robëri. Kurse çiftet që nuk gjejnë dot zgjidhje në këtë rrugë qorre, më në fund rrokullisen në batakun e një jete të devijuar e perverse. Ja pra, për këtë arsye, kur krijohen kushte të detyrueshme, Islami e ka bërë hallall ndarjen. Dhe, vendimin për këtë, e ka lënë në dorë të burrit, i cili është më i aftë të sillet me maturi.



Sipas Islamit, lënia e të drejtës së ndarjes në vullnetin e burrit, është për shkak të ndjeshmërisë së gruas. Por, nëse gjatë aktit të nikahut vendoset që e njëjta e drejtë t'i takojë edhe gruas, atëherë për këtë nuk ka asnjë pengesë. Përveç kësaj, edhe nëse nuk është vendosur ndonjë kusht i tillë, kur paraqiten raste serioze, gruaja ka të drejtë t'i drejtohet organeve kompetente për të kërkuar ndarjen.

Për t'u ruajtur nga ndarjet e panevojshme, është e domosdoshme që burri dhe gruaja të njohin reciprokisht vlerat e njëri-tjetrit dhe po në mënyrë reciproke t'i ruajnë ato. Ditët e lumtura të shokëve të jetës, kujtimet e bukura dhe të thella, gëzimet e sinqerta, rehatia, paqja dhe mirësia arrihen gjithmonë nën hijen e kriterëve hyjnore. Dhe kjo, vjen në sajë të besnikërisë dhe sinqeritetit ndaj njëri-tjetrit të të dyja palëve si robër të Allahut. Në hadithet fisnike, thuhet:

“Nëse dikush e zgjon gruan e tij natën dhe falin dy rekat namaz së bashku ose veç e veç, ata do të shkruhen prej burrave dhe grave që e përmendin shumë Allahun.” (Ebu Daud, Tatauu 18, Vitir 13)

“Allahu e mëshiroftë atë që ngrihet natën dhe fal namaz; që ngre edhe gruan e tij, madje edhe nëse ajo nuk ngrihet, e zgjon atë duke e



spërkatur me ujë! Gjithashtu, Allahu e mëshiroftë edhe atë (grua) që ngrihet natën e fal namaz; që e zgjon edhe burrin e saj, madje edhe nëse ai nuk zgjohet, ia heq gjumin duke e spërkatur me ujë!”

(Ebu Daud, Tatauu, 18, Vitir 13)

Kuptimi që del nga këto hadithe fisnike, është se lumturia familjare, varet nga dy parime të mëdha:

- 1. Sinqeriteti midis dy palëve,**
- 2. Nxitja e njëri-tjetrit në devotshmëri.**

Nëse i mbledhim të gjitha këto që shpjeguat dhe na duhet të tregojmë një çerdhe familjare ideale dhe shembullore, a kemi shembuj të sukses-shëm para nesh?

Sigurisht, është e mundur të jepen shumë shembuj. Mirëpo, në krye të të gjithave, padyshim qëndron çerdhja e ngrohtë dhe e lumtur që ndërtoi Pejgamberi (a.s.).

Pejgamberi (a.s.), është shembulli dhe udhëzuesi më i mirë për çdo fazë dhe çështje të jetës. Për rrjedhojë nga aspekti i lumturisë dhe paqes familjare, ai ka ndërtuar një çerdhe që është shembull për gjithë



njerëzimin. Gjithashtu, në çdo aspekt ai ka shfaqur një jetë të përsosur e të begatë. Pra, për një familje, ai është shembulli edhe i burrit, edhe i babait më të përsosur. Ndërsa bashkëshortja e tij e nderuar, Hadixhja (r.a.), ishte shembulli më i përsosur i një gruaje dhe i një nëne. Edhe bashkëshortet e tjera të tij ishin kështu...

Shkurtimisht, në çerdhen familjare që ndërtoi, ai nuk shfaq asnjë sjellje negative. Ky, është një sukses jashtë imagjinatës. Sigurisht, për shkak se ata ishin qenie njerëzore, ka pasur edhe probleme të vogla midis tij dhe grave. Mirëpo, në sajë të moralit të lartë dhe karakterit ideal që zotëronte, të gjitha kanë përfunduar me mirësi e begati, duke u bërë shembull për të gjithë umetin, se si duhet vepruar në çështje të tilla.

Për rrjedhojë, çerdhja familjare e Pejgamberit (a.s.), ashtu si edhe karakteri i tij i lartë, në çdo aspekt është çerdhja më ideale dhe më shembullore.

Ajo ishte çerdhja më e ngrohtë dhe më me dashuri në botë, aq sa edhe pse nuk gatuhej një gjellë e ngrohtë për ditë të tëra, ajo lëshonte aromë lumturie. Mbi të gjitha, dhomat e grave në atë çerdhe të bekuar, ishin vetëm sa për të futur kokën. Mirëpo, mirësia më e ëmbël e asaj çerdheje, ishte mjaftueshmëria, durimi dhe dorëzimi. Metoda e



edukimit që zbatoi Resulullahu në jetën familjare, i kishte mbushur zemrat e tyre (grave) me një lidhje dhe dashuri të pafundme. Asnjë grua, nuk e do burrin e saj aq sa e deshën nënat tona të Dërguarin e Allahut (a.s.). Dhe, asnjë burrë nuk e do gruan e tij, në të njëjtën gradë të dashurisë që kishte i Dërguari i Allahut (a.s.), për bashkëshortet e tij. Asnjë fëmijë, nuk e do babanë e vet ashtu siç e deshi Fatimja (r.a.), babanë e saj. Dhe, asnjë baba nuk e do fëmijën e tij, ashtu siç e deshi i Dërguari i Allahut vajzën e tij Fatimen (r.a.).

Pejgamberi , salallahu alejhi ue selem, e ka respektuar në mënyrë të jashtëzakonshme drejtësinë midis bashkëshorteve të tij, të cilat konsiderohen edhe si nënat e besimtarëve. Në lidhje me këtë çështje, ai është përpjekur me të gjitha mundësitë që kishte. Mirëpo, duke e pranuar vështirësinë e mbajtjes së drejtësisë absolute, ai kërkoi ndihmë prej Allahut të Madhëruar me këto fjalë:

“O Zot! Ka mundësi që pa e kuptuar, dikë prej tyre ta dua më shumë se tjerat. Dhe kjo, do të ishte një padrejtësi. Prandaj, o Zoti im! Strehohem tek mëshira Jote për atë që nuk mund ta realizoj dot në këtë çështje!..”⁹

9. Në këtë dua dhe përgjërimit, gjenden shumë urtësi në shprehjen e dobësisë dhe pamundësisë nga ana e Resulullahut (a.s.). Njëra prej këtyre, është se kjo e bën umetin e tij, i cili duhet ta marrë she-

O Zoti ynë! Na fal neve dhe familjeve tona një jetë të devotshme me adhurime dhe bindje ndaj Teje, prej të cilave Ti do të jesh i kënaqur. O Zot! Bëji shtëpitë tona xhenet të mirësisë dhe lumturisë dhe mos i bëj dënim xhehenemi i cili ndizet prej sjelljeve arrogante e të pakujdes-shme!

Amin!..

mbull atë në çdo çështje, të mos e harrojë kurrë faktin se ai është vetëm një njeri. Sepse disa prej popujve të mëparshëm, për shkak se treguan respekt dhe madhërim të tepërt ndaj Pejgamberëve të tyre, devijuan nga besimi i teuhidit (në një Zot) dhe shkuan deri aty sa i hyjnizuan pejgamberët e tyre. Për këtë arsye, feja Islame, në shprehjen e dëshmisë e cila përbën themelin e besimit, para se të përmendet cilësia e Pejgamberit (a.s.), si **“i Dërguari i Allahut”**, theksohet cilësia e tij si **“Rob i Allahut”**. Padyshim se, edhe sjelljet që e trajtojnë atë vetëm me anën e tij si rob, duke mos e përfillur cilësinë e tij si i Dërguar, tregojnë një injorancë dhe mungesë të madhe dashurie.



*Çështjet që duhet
të kenë kujdes
gratë në familje*



*“Gruaja e mirë, e gëzon burrin
kur ai shikon fytyrën e saj, i plotëson
kërkesat e ligjshme të burrit të saj
dhe e ruan pasurinë dhe nderin e tij
kur ai nuk ndodhet aty.”*

(Ibn Maxhe, Nikah, 5/1857)

Cilat janë pikat që duhet të ketë kujdes gruaja në aspektin e sigurimit të paqes dhe lumturisë në çerdhen familjare?

Para së gjithash, si domosdoshmëri e krijimit tonë, gratë duhet të bëjnë kujdes në adhurimin dhe devotshmërinë ndaj Allahut. Në këtë çështje, përveç kujdesit që duhet të tregojnë ndaj adhurimeve, namazit etj., ato duhet të bëjnë kujdes edhe ndaj hallallit dhe haramit.

Devotshmëria dhe qëndrimi i gruas në rrugë të drejtë, duhet të jetë faktor nxitës i mirësisë dhe bamirësisë tek burri, fëmijët, të afërmit dhe fqinjët e saj. Një grua e mirë, është si një lule me aromë xheneti, e cila përhap lumturi rreth vetes.



Detyra më e rëndësishme për gratë pas devotshmërisë ndaj Allahut, është të bëjnë të lumtur burrat dhe pjesëtarët e tjerë të familjes. Lumturia që u japin burrave dhe familjes së tyre, i bën ato të fitojnë kënaqësinë e Allahut. Lidhur me këtë, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Gruaja e mirë, e gëzon burrin kur ai shikon fytyrën e saj, i plotëson kërkesat e ligjshme të burrit të saj dhe e ruan pasurinë dhe nderin e tij kur ai nuk ndodhet aty.” (Ibn Maxhe, Nikah, 5/1857)

Prandaj, gruaja duhet të kërkojë mënyrat për ta bërë të lumtur burrin e saj, duke fituar kënaqësinë e tij.

I nderuar, nëse e hapim edhe pak këtë temë, cilat janë pikat që duhet të ketë kujdes gruaja në shtëpinë e saj në jetën e përditshme?

Brenda shtëpisë, ajo duhet të kujdeset për veten; për pamjen dhe pastërtinë e saj. Nëse gruaja është e papastër dhe e çrregullt, asaj i bie vlera edhe para syve të një burri të thjeshtë. Ajo duhet të ruhet nga çdo lloj pamje e pahijshme pranë burrit të saj. Zemra e atij që nuk e gjen në shtëpinë e tij atë që



kërkon, rrëshqet në vende të gabuara jashtë shtëpisë së tij dhe si rezultat shkatërrohet lumturia familjare. Prandaj, në shtëpi, gruaja duhet të jetë si një buqetë e mbledhur nga lule me ngjyra dhe aroma të ndryshme dhe duhet të reflektojë lumturi dhe paqe tek burri i saj. Ndërsa burri duhet ta presë me padurim mbrëmjen dhe nuk duhet ta urrejë kthimin në shtëpi në mbrëmje.

Gruaja e mirë, duhet ta presë burrin e saj tek dera dhe e buzëqeshur. Po ashtu edhe kur del nga shtëpia duhet ta përcjellë atë me fjalë të bukura dhe dua. Edhe në ditët kur ndihet shumë e lodhur, ajo nuk duhet ta reflektojë këtë tek burri dhe nuk duhet të shtrembërojë fytyrën pranë tij. Ajo duhet t'i kuptojë vështirësitë e burrit dhe duhet ta ndihmojë atë të çlodhet.

Bashkëshortët nuk duhet t'ia prishin qetësinë njëri-tjetrit me mërzitje të tepërta dhe ankesa vend e pa vend. Lidhur me këtë, është me vend të kujtojmë sjelljen shembullore të Ummu Sulejmit (r.a.) karshi burrit të saj:

Edhe pse i kishte vdekur djali, ajo nuk ndaloi nga shërbimi dhe sakrifica ndaj burrit të saj. Sipas transmetimit, djali i sëmurë rëndë i Ebu Talhasë (r.a.), kishte ndërruar jetë kur ai nuk ndodhej në shtëpi. Kur Ummu Sulejme e pa që djali i saj kishte



ndërruar jetë, e lau dhe qefinosi atë. Më vonë, kur Ebu Talha (r.a.), erdhi në shtëpi, pyeti:

“- Ku është djali?” Ummu Sulejme (r.a.), tha:

“- Djalit iu qetësuan dhimbjet dhe tani besoj se po rehatohet pak.” Madje, Ummu Sulejme i porositi njerëzit e shtëpisë duke u thënë:

“- Kujdes, mos i tregoni Ebu Talhas për vdekjen e djalit, deri sa t’i tregoj vet!..”

Më pas, i solli ushqimin burrit të saj dhe ai hëngri. Ndërsa Ummu Sulejme (r.a.) u zbukurua dhe doli para tij. Më vonë, ata shkuan të çlodheshin në dhomën e tyre. Në mëngjes, në momentin kur Ebu Talha (r.a.), po bëhej gati dilte nga shtëpia, Ummu Sulejme, e cila ishte një grua e zgjuar dhe e devotshme, i tha:

“- O Ebu Talha! Pa shiko ç’bëri ky fqinji ynë... Kur i kërkova amanetin që ia kisha dhënë për ta përdorur, ata s’deshën të ma jepnin.” Ebu Talha (r.a.), u përgjigj:

“- Jo nuk bën kështu. Nuk kanë vepruar aspak mirë!” Pas këtyre fjalëve, Ummu Sulejme (r.a.), tha:

“- O Ebu Talha! Djali yt ishte një amanet i Allahut tek ty dhe Ai e mori përsëri.” Ebu Talha papritur u shastis, heshti dhe më pas tha:



“- Ne jemi të Allahut dhe padyshim se tek Ai do të kthehemi!”

Kur shkoi në xhami për të falur namazin, ia tregoi Pejgamberit (a.s.), gjithçka që kishte ndodhur. Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), bëri dua duke thënë:

“- Allahu jua begatoftë këtë natë!”

Pa kaluar një vit prej kësaj duaje, Allahu i fali kësaj familjeje një tjetër djalë. Pejgamberi (a.s.), duke i dhënë pak hurmë bëri dua për këtë fëmijë dhe ia vuri emrin Abdullah. Transmetohet se, po në sajë të kësaj duaje, Abdullahut i lindën shtatë apo nëntë fëmijë dhe që të gjithë u bënë hafiza. (Buhari, Xhenaiz 42, Akikal; Muslim, Edeb 23)

Çfarë duhet të ketë tjetër parasysh një grua e mirë në marrëdhëniet me burrin e saj, për të siguruar një ambient të ngrohtë familjar?

Ajo nuk duhet ta neglizhojë kurrë burrin e saj dhe nuk duhet ta vërë atë në radhë të dytë ndër pjesëtarët e familjes. Për shkak se kjo gjendje bie ndesh me natyrën e krijimit, një burrë normal nuk mund ta pranojë një sjellje të tillë të gruas.



Për ta kënaqur një njeri, duhet ta njohësh shumë mirë atë. Për këtë arsye, gruaja duhet të përpiqet ta kuptojë burrin e saj, idealet, interesat dhe ndjenjat e tij; të ndajë me të dëshirat dhe të mos shkëputet kurrë prej tij. Përkundër kësaj, edhe burri duhet të veprojë në të njëjtën mënyrë me gruan e tij. Nëse nuk i japin rëndësi kësaj, “**uniteti dhe pikat e për-bashkëta**” si rrjedhojë e natyrshme e bashkëshortësisë, do të pakësohen dita ditës dhe me kalimin e kohës bashkëshortët do të largohen nga njëri-tjetri. Nëse nuk merren masa në kohën e duhur, pas një farë kohe, kjo gjë merr një përmasë të atillë, saqë dashurinë dhe unitetin midis bashkëshortëve e zë ndarja dhe urrejtja. Dhe, periudha më e keqe e kësaj, është pleqëria, sepse ndarja në moshën e pleqërisë të atyre që kanë kaluar me vitet të tërë së bashku dhe nuk janë përpjekur ta njohin e ta kuptojnë njëri-tjetrin, shkakton një vetmi të hidhur dhe një pendesë të pakthyeshme.

Gruaja, duhet ta ndihmojë burrin e saj në çdo punë të mirë e të lejuar. Ajo nuk duhet të tregojë mungesë respekti ndaj të afërmve të tij. Nëse vihet në pozitën e zgjedhjes midis dëshirës dhe sakrificës, ajo duhet të tregojë më tepër afërsi ndaj familjes së tij.



edhe periudha fatkeqësie dhe problemesh. Prandaj, në periudha të tilla, ajo duhet të gjendet pranë burrit të sajë dhe të përpiqet t'ia lehtësojë barrën atij.

Ngjashëm me këtë, janë thënë shumë fjalë të urta dhe aforizma. Për shembull, duke u frymëzuar nga këto fjalë, në çaste të vështira thuhet; *“Edhe nëse të rrjedh gjak nga goja, thuaj se piva lëng qershie!”*. Një fjalë tjetër thotë: *“Në çerdhen familjare duhet hyrë me fustan nusërie. Shtëpinë duhet ta mbushësh me lumturi dhe prej as dere duhet dalë për në udhëtimin e përjetshëm me një qefin të bardhë e pa njolla.”*

Pejgamberi (a.s.), nuk mundi ta harronte një jetë të tërë durimin e gruas së tij të parë Hadixhes (r.a.), mirëkuptimin, dorëzimin dhe sakrificën e saj, duke e përkujtuar gjithmonë me dua.

Shkurtimisht, njerëzit duhet të duan, që të duhen; duhet të respektojnë, që të respektohen. Duhet të jesh flijues, që në këmbim të marrësh mirësi. Mirëpo, në një familje, në radhë të parë këto duhet të vijnë nga gruaja. Natyrisht që, gruaja e mençur, e bën burrin e saj që ta dojë dhe bëhet arkitektja e rrugës së lumturisë. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Gruaja që vdes ndërkohë që burri i saj është i kënaqur me të, hyn në xhenet.” (Tirmidhi, Rada, 10)



Ky hadith fisnik, na lajmëron edhe për shpërbimin e një gruaje të mirë nëse ajo e kënaq burrin e saj, por cek edhe pozitën e burrit në familje dhe moralin e gruas.

Ndërsa burri duhet të bëjë kujdes të fitojë hallall me punën e tij. Ai duhet të bëjë kujdes që të mos i ushqejë me gjëra të dyshimta gruan dhe fëmijët e tij, të cilët nuk e dinë burimin e shpenzimeve që bëhen.

Në një hadith tjetër, thuhet:

“Bukuria e njeriut është e fshehur në fenë e tij, fisnikëria dhe nderi në mendjen e tij, ndërsa bukuria e sojit, në moralin e tij.” Me këtë, ai na ka bërë të ditur kriteret e nevojshme që duhen pasur kujdes gjatë zgjedhjes së bashkëshortit/es.

Gruaja e mirë, nuk duhet të mjaftohet vetëm me dashurinë dhe respektin që tregon ndaj burrit të vet, por duhet të tregojë afërsi brenda kuadrit legjitim edhe për të afërmit dhe miqtë e tij. Kjo sjellje e gruas, e kënaq burrin e saj. Mirëpo, këtu ka një pikë në të cilën duhet pasur kujdes. Dhe kjo, është respektimi i kufijve të intimitetit që ka përcaktuar Islami. Kur gruaja është e vetme në shtëpi, ajo nuk duhet ta pranojë në shtëpi një të afërm me të cilin -sipas Islamit- i lejohet martesë. Kjo, është një çështje tepër delikate. Askush nuk duhet të vendosë syzet



e qëllimit të pastër e të mirë dhe të rrënojë muret e intimitetit. E në mënyrë të veçantë, gruaja duhet të ruhet nga njollosja e vetvetes. Kjo, sepse gruaja është si një rrobë e bardhë, në të cilën bie në sy edhe njolla më e vogël. Edhe Pejgamberi (a.s.), ka dëshiruar të qëndrohet larg çdo pune që mund të ngjallte dyshime:

Një mbrëmje, i Dërguari i Allahut (a.s.), po ecte në një rrugicë me një prej grave të tij. Përball tij po vinin dy sahabë prej ensarëve, të cilëve u foli në formë prezantimi:

“- Kjo është nëna juaj Safije binti Hujej.”
Sahabët thanë:

“- O Rasulullah! Allahu është i pastër dhe është e pamundur që i Dërguari i Tij të veprjë gjëra të papërshtatshme.” Pas këtyre fjalëve, Resulullahu (a.s.), tha:

“- Shejtani shëtiti si gjaku në trupin e njeriut. Prandaj, unë kam frikë se mos ju hedh ndonjë të keqe -apo dyshim- në zemrat tuaja.” (Buhari, I'tikaf, 11; Muslim, Selam 23-25) Në këtë mënyrë, ai i porosiste njerëzit të mos bëheshin shkaktarë të dyshimeve dhe akuzave.

Gratë duhet të jenë gjithmonë pranë burrave të tyre në punë të lejuara, me qëllim që burrat të



gjejnë ngushëllim tek to dhe t'u shtohet dëshira për punë. Siç dihet, mirësitë dhe bukuritë shtohen aq sa ato ndahen me të tjerët; ndërsa fatkeqësitë dhe hidhërimet pakësohen. Bashkëshortët, nuk duhet të harrojnë kurrë se janë shoku i jetës së njëri-tjetrit edhe në udhëtimin e kësaj bote, edhe në udhëtimin e botës tjetër. Ndërkohë që më parë secili prej tyre kishte një jetë private, me martesën u bënë pjesë të një jete dhe fati të përbashkët. Për rrjedhojë, ata duhet të respektojnë detyrimet e jetës së përbashkët dhe duhet të kujdesen gjithmonë për njëri-tjetrin në zbritjet apo tatëpjetat e jetës. Nëse njërit i pengohet këmba, tjetri duhet t'i bëhet bastun dhe nëse rrëzohet, tjetri duhet ta kapë përdore dhe ta ngrejë.

Gruaja, duhet të bëjë kujdes ndaj sjelljeve të burrit të saj dhe, kur e vë re se ai nevríkose në një çështje, ajo nuk duhet ta zmadhojë çështjen dhe nuk duhet ta çojë deri në grindje. Kjo, sepse grindjet serioze dhe afatgjate, e cenojnë dashurinë dhe respektin midis tyre, duke e vënë në rrezik çerdhen familjare. Në raste të tilla, është e domosdoshme që gratë të bëjnë kujdes në sjelljet e tyre ndaj burrave, duke vazhduar të jenë të edukuara. Më në fund, edhe burri do ta kuptojë gabimin e vet dhe do ta respektojë gruan e tij edhe më shumë. Përndryshe, edhe pse mund të jetë në gabim, ai nuk ka për ta parë këtë padrejtësi që po bën dhe shejtani i cili ka



hyrë midis tyre, do të mbjellë urrejtje dhe armiqësi në të dyja zemrat.

Një çështje tjetër në të cilën duhet të bëjnë kujdes bashkëshortët, është mosbesimi dhe xhelozia e tepërt. Një nga gjërat që i shqetësojnë më shumë njerëzit, është edhe mosbesimi që tregohet ndaj tyre. Nëse lidhur me këtë çështje dalin në pah shumë probleme serioze, para se të fajësojnë njëri-tjetrin, duhet të ulen e të provojnë të flasin. Pra, nuk duhet t'i zmadhojnë çështjet e imëta dhe t'i kthejnë në probleme të mëdha nga ku nuk mund të dilet më.

Disa njerëzve, mund t'ju mungojë intuita në lidhje me disa çështje. Mund të harrojnë ose të gabojnë. Prandaj, nëse gruaja e sheh se burri ka nevojë të këshillohet, duhet që ta bëjë atë të ndjejë se ajo është pranë tij me gjithë sinqeritetin dhe qëllimin e mirë. Dhe, në këtë çështje duhet të thotë më të drejtën e atyre që di. Ajo duhet të jetë njeriu më i besuar i tij.

Nuk duhet harruar se, burri dhe gruaja, janë elemente që e plotësojnë njëri-tjetrin. Për rrjedhojë, edhe gratë e Pejgamberit (a.s.), që janë edhe nënat e besimtarëve, shpesh herë e kanë ndihmuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), me mendimet e tyre. Për shembull, gjatë Marrëveshjes së Hudejbijes, sahabët shfaqën pakënaqësi në lidhje me pikat e marrëveshjes. Për këtë shkak ata po tregonin ngurrim



në zbatimin e urdhrave të Pejgamberit (a.s.), i cili u hidhërua shumë nga kjo gjë. Mirëpo, nëna jonë Ummu Seleme (r.a.), e cila ndodhej aty, e ngushëlloi Pejgamberin (a.s.) dhe e këshilloi që urdhrin e dhënë ta zbatonte vetë pa pritur të tjerët. Kjo, sepse ajo e pa se, nëse Pejgamberi (a.s.), nuk e zbatonte vetë i pari urdhrin e rruajtjes së kokës dhe daljes nga ihrami, kishte mundësi që vendimet e marra në Hudejbije të tërhiqeshin, gjë për të cilën edhe sahabët ishin në pritje. Nëse e shohim në plan të parë, për atë moment ata nuk e kishin kuptuar urtësinë e vendimeve të marra në Hujdejbije dhe po prisnin që të hiqej dorë nga ato. Mirëpo, në sajë të këshillës jashtëzakonisht me vend të nënës sonë Ummu Seleme (r.a.), Pejgamberi (a.s.), e rroi kokën dhe doli nga ihrami. Kur sahabët e panë këtë, dolën nga ihrami kokulur dhe kjo çështje u zgjidh pa u lënë vend përfundimeve të hidhura.

Po ashtu, kur Pejgamberi (a.s.), mori shpalljen e parë, nëna jonë Hadixhe (r.a.), e ngushëlloi, ndau me të mërzitjen dhe shqetësimin dhe, duke e ndihmuar të takohej me Uaraka bin Neufelin, fitoi kënaqësinë e Pejgamberit (a.s.).

Në historinë Islame, një shembull i ngjashëm përmendet edhe në lidhje me Omerin (r.a.). Kur gjendeshin në xhami, Omeri po thoshte se gratë po kërkonin tepër mehir, gjë e cila po e vështirëson-



te martesën. Për këtë arsye, ai deshi ta kufizonte sasinë e mehrit. Në atë moment, një grua, e cila po e dëgjonte Omerin nga radhët e fundit, u ngrit në këmbë dhe e kundërshtoi atë, duke lexuar ajetin e 20 të sures en-Nisa, ku theksohet se gratë mund të kërkojnë mehir aq sa të duan. Pas kësaj, Omeri e kuptoi gabimin dhe e ndërroi mendimin duke thënë:

“- *Gruaja foli drejtë, Omeri u gabua.*” (Ali el-Muttaki, XVI, 536-537/45796)

Megjithatë, këtu kemi edhe një çështje të rëndësishme mbi të cilën duhet të ndalemi. Ndërkohë që gruaja është duke këshilluar në çfarëdolloj çështjeje, edhe sikur mendimi i saj të jetë i drejtë, ajo duhet të ruhet nga mendjemadhësia. Kur i jep mendime dhe këshilla burrit të saj në çfarëdolloj çështjeje, ajo nuk duhet të dalë jashtë respektit dhe nuk duhet ta ulë burrin duke e treguar veten më të mençur. Kjo, sepse burrat nuk e kanë fort qejf të marrin këshilla prej grave. Me pak fjalë, gruaja e mirë, mirësinë e mendjes që i ka dhënë Allahu, duhet të dijë ta përdorë me kujdes ndaj burrit.

Një grua, duhet të gëzojë artin dhe marifetin për të hyrë në shpirtin e burrit të saj. Në histori gjenden shumë shembuj të këtij fakti. Shumë gra sulltanësh kanë ditur t’ua fitojnë zemrën burrave të tyre dhe kanë arritur të bëhen ortakë në sundimin tyre. Dhe,



në këtë mënyrë ato kanë lënë pas shumë xhami dhe institucione të ndërtuara si sadaka-i xharije¹⁰ për veten e tyre. Për rrjedhojë, ato ende përkujtohen me dua të mira për shkak të këtyre mirësive që kanë bërë.

Gjithashtu, nëse gruaja mundohet ta kritikojë apo ta këshillojë burrin e saj pranë të tjerëve, edhe kjo është në kundërshtim me rregullat e edukatës. Sado i gabuar qoftë, ajo nuk duhet ta turpërojë atë duke i nxjerrë në shesh të metën!.. Në të njëjtën mënyrë, një sjellje e tillë është e gabuar edhe për burrin, sepse në një ajet fisnik, urdhërohet: “**...Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato...**” (Bekare, 187)

Po ashtu, përkundër mangësive dhe të metave të burrit të saj, është e gabuar që gruaja të lavdërojë një burrë tjetër pranë burrit të saj. Ajo nuk duhet të ankohet për burrin e saj as tek nëna dhe as tek babai i saj. Gjithashtu duhet të bëjë kujdes të mos e vërë në pozitë të vështirë pranë askujt. Në vend që t’i reflektojë mosmarrëveshjet midis tyre tek të tjerët, ata duhet të mundohen t’i zgjedhin ato ndërmjet tyre.

Sot jemi dëshmitarë se në disa martesë, në

10. **Sadaka Xharije:** Një vepër e mirë, e cila vazhdon edhe pas vdekjes së personit. P.sh. edukimi i brezave, mbjellja e një peme, etj., prej të cilave do të kenë dobi njerëzit dhe krijesat e tjera edhe pas vdekjes së personit.



themel të mosarritjes së lumturisë nga të dyja palët, qëndron mos vlerësimi i burrave nga gratë ose i grave nga burrat e tyre. Mirëpo, burri dhe gruaja, mund të jenë edhe xheneti, por edhe xhehenemi i njëri-tjetrit. Nëse gruaja tregon kujdes në devotshmërinë ndaj Allahut dhe fiton kënaqësinë e bashkëshortit të saj duke iu përgjigjur pozitivisht kërkesave të tij, kjo grua e mirë është në rrugën drejt xhenetit.

Çfarë përgëzimesh ka bërë Pejgamberi (a.s.), në lidhje me gratë e mira?

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Pas devotshmërisë, besimtari, me tepër mirësi gjen tek një bashkëshorte e mirë. Nëse e urdhëron këtë grua, ajo i bindet, nëse e shikon atë, ndjen gëzim dhe nëse ai betohet të bëjë apo të mos e bëj diçka, ajo vepron atë që duhet dhe e shpëton burrin nga betimit. Po ashtu, nëse ai largohet dhe shkon në një vend të largët, gruaja ruan edhe namusin e saj, por vepron me drejtësi edhe në lidhje me pasurinë e tij.” (Ibn Maxhe, Nikah, 5/1857)

“Kjo botë është një pasuri (gjithçka nga e cila përfiton përkohësisht). Dhe, pasuria më e mirë e saj është gruaja e mirë (e ndershme dhe fetare).” (Muslim, Rada, 64; shih. Nesai, Nikah, 15)



Theubani (r.a.), transmeton se:

Kur u zbrit ajeti; “...**Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.**” (Teube, 34) ne ishim duke udhëtuar së bashku me Resulullahun (a.s.). Disa prej sahabëve, thanë:

“- Ka zbritur gjithçka që mund të zbriste në lidhje me arin dhe argjendin (tashmë nuk do t’i mbledhim më, por do t’i dhurojmë). Ah sikur ta dinim se cila është pasuria më e mirë dhe të fitonim prej saj!..” Sapo dëgjoi këto fjalë, Resulullahu (a.s.), tha:

“*Më e çmuara prej atyre që posedohen, është një gjuhë që e përmend Allahun, një zemër falënderuese dhe një grua e mirë që e ndihmon besimin e burrit të saj...*” (Tirmidhi, Tefsir, 9/9)

Në ditët tona, po kalojmë shumë vështirësi dhe probleme në aspektin material. Çfarë duhet pasur kujdes në lidhje me kamjen apo skamjen në familje, që të mos cenohet paqja dhe lumturia familjare?



kërkojnë çdo gjë që shohin, duke kaluar kufijtë e buxhetit të tyre, sepse kjo bëhet shkak i një ngarkese tepër të rëndë, i shqetësimeve dhe problemeve të mëdha. Për shkak të kartave të kreditit që janë përhapur mjaft në ditët tona, shumë familje mendojnë se mund të zotërojnë lehtë dhe lirë çdo gjë që shohin. Dhe, për arsye të shpenzimeve pa kriter që bëjnë, bien në vorbullën e borxhit dhe kamatës, duke shkaktërruar veten. Shumë familje të lumtura janë rrënuar ose janë në prag të rrënimit për këtë arsye. Edhe nëse gjendja materiale e bashkëshortëve është e mirë, nuk duhet të bëhen shpenzime të tepërta dhe duhet ruajtur nga shpërdorimi. Kjo, është një përgjegjësi edhe për gruan, edhe për burrin. Allahu na ruajt, por vjen një ditë që ato të cilat janë shpenzuar pa kriter, fillojnë dhe kërkohen. Allahu i Madhëruar, në Kuranin fisnik, urdhëron:

“Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepëruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.” (Isra, 26-27)

Nëse ka ushqime, pije dhe veshje të tepërta, duhen kërkuar e gjetur nevojtarët dhe të ndahet e drejta e tyre, sepse të gëzosh zemrat e të varfërve dhe nevojtarëve, duke marrë duatë e tyre të mira, i gëzon dhe i begaton me furnizim çerdhet familjare.



Nuk duhet harruar kurrë se, ne mund të ishim si ata dhe ata mund të ishin si ne. Ndërsa kriteri ynë në dhurim, duhet të jetë ajeti; **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”**¹¹

Kur të bëhen dhurime për bamirësi, më shumë se veshjet e përdorura apo sendet e vjetëruara, duhet të jepen gjëra që kanë vlerë në ditë tona dhe gjërat e çmuara që kanë zënë vend në zemrat tona. Në një hadith fisnik, në mënyrë metaforike, thuhet:

“Ajo që dhurohet, në fillim shkon në dorë të Allahut; dhe prej dorës së Tij, kalon në dorën e nevojtarit.” (shih. Ihja Ulumu'd-Din)

Duhet theksuar se, respektimi i kriterëve të shpenzimit në jetën familjare, së pari është një detyrë që i takon gruas. Nëse ajo e bën zakon të jetë modeste dhe e përmbajtur në çështjet e ushqimit dhe veshjeve, e në mënyrë të veçantë bën kujdes të jashtëzakonshëm ndaj shpërdorimit, në familje do të mbizotërojë begatia dhe paqja, edhe nëse të ardhurat janë të pakta. Prandaj, fillimi i gatimit me Bismilah, përdorimi i gjërave në sasi të mjaftueshme dhe mos kërkimi i gjërave të cilat e vështirësojnë buxhetin e familjes, janë sjelljet më thelbësore prej të cilave buron lumturia në familje.



Sot, për shkak të mosrespektimit të këtyre kriterëve, hedhja çdo ditë në plehra e tonelatave me bukë, është një e vërtetë e hidhur që e shkatërron begatinë tonë. Ndërsa një grua nikoqire, ashtu siç duhet të bëjë kujdes për bukën dhe çdo gjë që hyn në shtëpi, ashtu duhet të tregojë kujdes edhe në përdorimin e tyre. Kjo, sepse prishja e diçkaje pa u konsumuar dhe hedhja e saj në plehra, është një lloj shpërdorimi të cilin mund ta parandalojnë vetëm gratë në familje.

Në të shkuarën, gratë kanë qenë jashtëzakonisht të kujdesshme dhe duararta për të qëndisur, për të qepur dhe për të arnuar veshjet. Mirëpo sot, sapo veshjet të pësojnë ndonjë grisje apo shqepje, shumë prej tyre preferojnë të marrin menjëherë diçka të re. Dhe ky, është një zakon shumë i keq i shpërdorimit.

Pika e fundit që desha të trajtoj në aspektin e detyrave të gruas në një familje të lumtur, ashtu siç e thamë edhe më parë, është fakti se; “Çerdhen e ndërton zogu femër”.

Nëse gratë i kryejnë detyrat që kanë në përgjegjësi, në mënyrë të vetëdijshme rreth kësaj të vërtete, do të thotë se çerdhet familjare janë kthyer në një xhenet. Ndërsa burrave, tashmë u takon t’ia dinë vlerën kësaj dhe ta ruajnë.



*Ështëjtet që duhet
të kenë kujdes
burrat në familje*



*Maturia në aspektin fetar dhe moral
të grave dhe fëmijëve; edukimi i tyre në
mënyrë që të fitojnë lumturinë e kësaj
bote dhe të botës tjetër, është një prej
detyrave më të rëndësishme të burrit.*

*Cilat janë çështjet të cilat duhet të
ketë kujdes një burrë në familje?*

Vendosja e lumturisë familjare në themele të shëndosha, mbështetet në vullnetin e një babai të mirë. Një baba i mirë, do të thotë; një baba i cili i kryen në mënyrën më të mirë detyrat si ruajtja dhe kujdesi për jetesën dhe edukimin e familjes. Dhe kjo, e bën të domosdoshme që ai të jetë i ditur, i zgjuar, me përvojë, i aftë dhe në mënyrë të veçantë me besim dhe moral të bukur.

*I nderuar, a mund të na e shpjegoni
pak më shumë se cilat janë detyrat
e babait ndaj familjes së tij?*



Kur burri vendos të martohet, para së gjithash ka nevojë për një burim jetese hallall, në sajë të së cilës do t'i sigurojë jetesën vetes dhe familjes ndaj së cilës ka marrë përgjegjësi.

Feja jonë madhështore, mundin e sigurimit të jetesës për familjen, ia ka ngarkuar burrit dhe, për shkak të kësaj, e ka rritur edhe pajën e tij në trashëgimi. Nisur nga kjo, nëse një burrë ka një burim jetese, ai duhet të hedhë hapin drejt martesës. Pra, nuk është e përshtatshme që një njeri i cili nuk mund të mbajë as veten e tij, të marrë në qafë edhe të tjerët. Megjithatë, Allahu i ndihmon ata që mendojnë të martohen me ato mundësi që kanë për ta jetuar sa më mirë fenë e tyre, sepse Allahu i Madhëruar, duke na kujtuar pafundësinë e mirësive të Veta, e ka inkurajuar martesën dhe ka urdhëruar:

“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju. Po ashtu edhe skllëvërit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm! Nëse janë të varfër, Allahu, do t'i begatojë ata me mirësinë e Tij; Allahu është i Gjerë në mirësi dhe i Gjithëdijshëm.” (Nur, 32)

Siç kuptohet edhe nga ky ajet fisnik; ata që kanë mundësi, duhet të martohen një orë e më parë. Ndërsa ata që nuk kanë mundësi vetjake për t'u martuar, duhet të ndihmohen nga të tjerët. Kjo,



është një detyrë e shoqërisë Islame dhe dera e një mirësie të madhe. Në këtë mënyrë, arrihet të ruhet nderi i shoqërisë dhe individit. Nder ky, i cili është një virtyt i lartë që i është falur njeriut, sepse tek krijesat e tjera nuk mund të mendohet ky lloj nderi. Nëse njeriu e humbet këtë virtyt njerëzor, ai bie në nivelin e krijesave të tjera.

Padyshim se, zgjuarsia, forca, aftësia, cilësitë dhe prirjet që Allahu i ka falur çdo njeriu, janë të ndryshme. Për këtë arsye, kanë dalë në pah edhe karaktere e profesione të ndryshme. Për sigurimin e vazhdimësisë së rregullit shoqëror, ka nevojë për çdolloj profesioni dhe mjeshtërit e këtyre profesioneve. Në një shoqëri, duhet të ketë edhe kasap, edhe pastrues, edhe doktor, edhe hoxhë... Prandaj, gjithkush sipas mundësive, duhet të përpiqet të krijojë një familje. Dhe ndërkohë që krijohet një familje, duhet pasur kujdes edhe barazia në çështjet shoqërore të të dyja palëve. Kjo, nuk nënkupton vetëm barazi në mundësitë materiale, por në të njëjtën kohë edhe në kulturë, dije dhe tradita. Nëse realizohet kjo, nuk do të ndodhin ndarje që e tronditin familjen për shkak të kërkesave të ndryshme nga të dyja palët. Pra, mirëkuptimi do të jetë më i lehtë. Për shembull, një burrë që martohet pa pasur pika të përbashkëta me gruan, ai nuk mund të jetojë lehtë me të, gjë e cila mund të kthehet në një dështim total. Këto lloj



dështimesh, është e mundur të evitohen në sajë të një dashurie të jashtëzakonshme. Por, këto janë përjashtime shumë të rralla. Për rrjedhojë, parimi i martesës midis familjeve të barabarta (në aspektet shoqërore), ka qenë gjithmonë zgjedhja më e dobishme dhe më e qëlluar.

Kjo, do të thotë se, përveç mundësive materiale, njerëzit me ndjenja shpirtërore, qëllime dhe dëshira të përafërta me njëri-tjetrin, kuptohen dhe afrohen më lehtë.

Nga ana tjetër, gjendja ekonomike e familjeve, përcaktohet sipas sasisë së punës dhe fitimit të burrit. Nëna dhe fëmijët, nuk kanë të drejtë të kërkojnë prej babait gjëra që e tejkalojnë fuqinë dhe fitimin e tij. Një baba, ka për detyrë të plotësojë nevojat e “strehimit, ushqimit dhe veshjes” në bazë të mundësive që i jep fitimi.

Strehimi, qoftë me qira, qoftë pronë private, duhet të zgjidhet me një hapësirë të mjaftueshme për banimin komod të pjesëtarëve të familjes dhe nëse është mundësia, të jetë në një lagje me fqinjë të mirë. Kur është e mundur të zgjedhësh, të preferosh të banosh në një vend me fqinjë të këqij e të pamoralshëm, ose në një vend jo të përshtatshëm për shëndetin, është një padrejtësi ndaj familjes. Maje kjo, me kalimin e kohës i përgatit truallin dobësimi



të moralit dhe shkatërrimit të çerdhes familjare.

Ndërsa kriteret e ushqimit, janë në bazë të fitimeve të burrit, si rezultat i një pune të ekuilibruar. Në këtë çështje, nuk duhet të jesh as dembel dhe as të marrësh përsipër ngarkesa tepër të rënda. Detyra e burrit, është të sigurojë ushqimin brenda këtij ekuilibri. Dhe, ky ekuilibër nënkupton ruajtjen nga shpërdorimi në shpenzime, por edhe nga shtrëngimi më tepër seç duhet. Për fat të keq, shpërdorimi është një nga problemet më të mëdha të ditëve tona. Sot, shumë njerëz janë moskokëçarës ndaj shpërdorimit. Mirëpo, burri është i detyruar të ruhet nga shpërdorimi, edhe nëse është i pasur. Përndryshe, ai do të shkatërrohet nën peshën e rëndë të shpërdorimit.

Të hash ushqim aq sa për të mos vdekur, është “farz” (e detyrueshme), të hash aq sa ke nevojë, është “mubah” (e lejueshme), por të hash me tepricë, është “haram” (e ndaluar). Të dashurit e Allahut, shpërdorimin në ushqim, e kanë ndarë sipas gradës së devotshmërisë në zemra:

- Sipas shariatit, shpërdorim është të hash pasi të jesh ngopur.

- Sipas devotshmërisë, shpërdorim është të hash deri sa të ngopesh.



- Sipas ihsanit, shpërdorim është të hash i pave-tëdijshtëm se ndodhesh para Allahut.

Baballarët duhet të tregohen të kujdesshtëm dhe të zgjuar në lidhje me ushqimet dhe veshjet që pëlqejnë njerëzit e familjes. Ata duhet të bëjnë kujdes ndaj fëmijëve që nuk kërkojnë asgjë për shkak se kanë turp apo janë të mërzitur, e sidomos ndaj vajzave.

Në gostitjen e miqve, ata duhet të tregohen xhymertë brenda normave të lejueshme. Kjo, është edhe një cilësi morale, por edhe një domosdoshmëri e nderit njerëzor.

Në lidhje me veshjet, babai është i detyruar t'i sigurojë vetes, gruas dhe fëmijëve të paktën nga dy veshje; një për dimër dhe një për verë. Ndërsa për ditë festash e gëzimesh, si ditët e xhumave, të bajrameve, të dasmave, etj., mund t'u blejë veshje të veçanta, gjë e cila është e lejuar. Feja islame, nuk e ka ndaluar as zbukurimin i cili bëhet brenda në një farë mase të caktuar. Mirëpo, veshja e rrobave tepër luksoze, për t'u mburrur e shitur mend, është e ndaluar fetarisht.

Burrave u është ndaluar veshja e rrobave prej mëndafshi dhe përdorimi i sendeve prej ari, si unazat apo orët. Në të njëjtën mënyrë, është e një gabim i madh edhe nëse i lejojmë fëmijët tanë të vegjël,



vajza apo djem qofshin, të veshin rroba shumë të hapura, të ngushta, apo të shkurtra me mendimin se janë ende të vegjël. Kjo, sepse me kalimin e kohës, ata mësohen me këto veshje dhe nuk do të mund të heqin dorë prej tyre, edhe nëse duan. Pra, ky gabim shkakton një helmim në botën e brendshme të fëmijëve. Prandaj, vajzat duhet të mësohen me veshjen islame që në moshë të vogël, duke i bërë ato ta kuptojnë mirë rëndësinë e kësaj veshjeje. Përndryshe, orientimet dhe zbatimet e gabuara, janë gjithmonë cenuese të nderit dhe ndjenjave të gruas.

Duhet ditur dhe mbajtur mend mirë se, veshja islame, përveç ruajtjes së nderit të gruas, ajo është edhe një bukuri dhe madhështi për të. Gratë e vetëdijshme të cilat vishen ashtu siç duhet, janë gjithmonë një shprehje e maturisë dhe vlerës për rrethin e tyre. Për rrjedhojë, në zemrat e të tjerëve, zgjohet vetëm ndjenja e respektit karshi tyre.

Çfarë duhet të kenë kujdes burrat në edukimin e familjes së tyre?

Edukimi i grave dhe fëmijëve në aspektin fetar dhe moral, në një mënyrë që të bëhet shkak i lum-



turisë së tyre në këtë botë dhe në botën tjetër, është një nga detyrat më të rëndësishme të burrit. Lidhur me këtë detyrë, në Kuranin Fisnik, urdhërohet:

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...” (Tahrim, 6)

Kuadri i kësaj detyre, sipas pozitës dhe mundësisë, duke filluar prej gruas dhe fëmijëve, përfshin, shërbyesit, fqinjët, të afërmit, shkollën, madje shkallë-shkallë, të gjithë atdheun. Kjo, sepse familjet ndikohen nga rrethi i jashtëm ashtu siç ndikohen edhe nga rrethi i brendshëm.

Babai, duhet t’i japë rëndësi edhe mësimin të Kuranit Fisnik të pjesëtarëve të familjes dhe, duhet t’i ndihmojë fëmijët e tij të shijojnë ëmbëlsinë e adhurimit. Nga ana tjetër, është e domosdoshme t’u mësohet edhe edukata e rregullat në lidhje me këtë botë dhe botën tjetër. Në këtë kuadër, kur fëmijët të vijnë në moshën shkollore, duhen dërguar në kurset fetare të verës dhe, kur të mbarojnë shkollën fillore, duhen dërguar patjetër të mësojnë Kuranin në kurset e Kuranit. Në mënyrë të veçantë, kjo është më e rëndësishme për vajzat. Nuk duhet harruar se, trashëgimia më e çmuar që mund t’i lënë prindërit fëmijëve të tyre, është ajo që lidhet me botën tjetër. Lum ata prindër që i bëjnë hafizë dhe i zbukurojnë



me kulturën e Kuranit fëmijët e tyre!.. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Kush e mëson Kur’anin dhe punon me të, në ditën e kijametit, prindërve të tij do t’u vendoset një kurorë. Drita e kësaj kurore, është më e bukur se sa drita e diellit kur bie në një shtëpi në këtë botë. Prandaj, mendoni se si do të jetë drita e atij që punon personalisht me Kur’anin Fisnik?!” (Ebu Daud, Vitr, 14)

Sot, për të mësuar një gjuhë të huaj, bëhen gjithë ato munde dhe nuk kursehet asnjë lloj shpenzimi. Përkundër kësaj, nënvleftësimi i kurseve të Kuranit dhe privimi i të vegjëlve tanë nga drita e tij, është diçka shumë e dhimbshme. Mirëpo, suksesi më i madh, është sigurimi i të mirave për jetën tonë pas vdekjes, duke lënë pas vetes një brez të mirë që lutet për ne.

Fëmijët tanë, duhet të rriten në atmosferën e begatë dhe frymëzuese të Kuranit, të historive të jetëve të peygamberëve dhe mesazheve hyjnore që përcjellin këto histori. Në këtë kohë, është e domosdoshme t’i pajisim fëmijët tanë me një motivacion besimi të tillë, në sajë të të cilit do të ruajnë veten prej fatkeqësive që sjellin humnerat e poshtërsive dhe pafesia. Për këtë arsye, pranë edukimit të Kuranit, duhet të jemi të fokusuar edhe në mësimin e historisë



së jetës së bekuar dhe shembullore të Pejgamberit (a.s.), sepse ai, me mënyrën e tij të jashtëzakonshme të jetesës, është tefsiri (komentimi) më i gjallë i Kuranit. Dhe, për të përvetësuar mënyrën e jetesës së Pejgamberit (a.s.), dhe për të zbatuar ashtu siç duhet Sunetin e tij, duhet të ecim në gjurmët e tij dhe të përpiqemi t'i ngjajmë atij, si në aspektin e jetesës ashtu edhe në atë të moralit.

Si rezultat i lënies pas dore të detyrave nga ana e prindërve dhe mosedukimi i fëmijëve në aspektin shpirtëror, drita e syve tanë, fëmijët, po rriten me një mentalitet materialist, si fëmijë rrugësh të prirur ndaj së keqes. Ata, televizioni po i ushqen me gjë, televizioni po u jep modelin e flokëve, televizioni po ju përcakton ndjenjat dhe ëndrrat. Në këtë mënyrë, prindërve u ngelet vetëm të luajnë rolin e shërbëtorëve që plotësojnë dëshirat e tyre. Në mënyrë të veçantë, gjendja e fëmijëve që kanë rënë pre e programeve të këqija dhe amorale në sajë të televizionit, internetit dhe mundësive të tjera, është jashtëzakonisht e keqe. Prandaj, të pranosh këtë gjendje që copëton zemrat, është alarmi i një dënimi, llogaria e të cilit është e pamundur të jepet.

Më e thjeshta; një fëmijë mysliman, i mëson përmendsh biografitë e shumë sportistëve dhe artistëve vendas e të huaj dhe, duke i marrë shembull,



përpiqet t'u ngjajë atyre. Ndërkohë që ai, nuk di as emrat e pejgamberëve tanë, të cilët ishin udhëzues të rrugës së të vërtetës dhe lumturisë. Ai nuk i njeh ata, rritet i huaj ndaj moralit të tyre të bukur dhe nuk merr mësim nga mesazhet e Kuranit në lidhje me ta. Kuptimi i kësaj të vërtete të hidhur, është se fëmijët tanë nuk i edukojmë ne, por të huajt. Kjo do të thotë se, rritja e trupit të tyre i takon prindërve, ndërsa orientimi i shpirtave të tyre, u takon të huajve. Vuajtjet i heqin prindërit, kurse përfitimet i ngelin të huajve. Për sa kohë që ata e kanë në dorë fitoren e kulturës dhe edukimit, nesër, kjo gjendje do t'i çojë ata në fitore të tjera kundra nesh -Allahu na ruajttë-. Për këtë arsye, ne duhet ta vulosim me fitore provën edukimit të fëmijëve tanë në mes të këtyre luftërave të pamëshirshme kulturore në sy të historisë. Ne duhet t'i edukojmë ata në bazë të nderit dhe ndjenjave tona. Fëmijët tanë duhet të gjelbërojnë mbi rrënjët dhe trungun e vet, që prej botës së tyre shpirtërore, e deri tek veshja.

Në lidhje me veshjen, Islami ka vënë disa rregulla të përshtatshme me ndjenjat njerëzore. Njëra prej tyre, është që veshja të mos jetë e ngushtë apo transparente aq sa të tregojë pjesët dhe linjat e trupit. Kur Resulullahu (a.s.), e pa motrën e Aishes (r.a.), Esmanë (r.a.), që kishte veshur një rrobë të hollë (të tejdukshme), ktheu kokën dhe tha:



“O Esmā! Pasi të kenë arritur moshën e pjekurisë, grave nuk u lejohet që t’u duket tjetër përveçse këtu e këtu -duke bërë me shenjë fytyrën dhe duart-” (Ebu Daud, Libas, 31)

Këto janë rregulla, të cilat Islami i ka vendosur për të penguar sjelljet që cenojnë nderin dhe ndjenjat e femrës. Dhe ky virtyt e nder të cilin gratë e gëzojnë si natyrë e krijimit të tyre, duhet të ruhet me kujdes si nga burri, ashtu edhe nga gruaja.

Nga ana tjetër, fëmijëve djem e vajza, u duhen ndarë dhomat pa ardhur ende në moshën e pjekurisë. Kjo është një nga çështjet e rëndësishme për të cilat duhet bërë kujdes, me qëllim që fëmijët tanë të piquen shpirtërisht dhe të fitojnë personalitetin e duhur.

Çfarë përgjegjësish kanë burrat në lidhje me mbrojtjen e familjes?

Burri, duhet ta ruajë familjen e tij prej çdolloj rreziku. Ai duhet t’i mbajë pjesëtarët e familjes larg programeve të këqija në televizion, librave, gazetave dhe botimeve që prishin vlerat fetare dhe bukurinë e moralit të familjes.

Me pak fjalë, detyra për ta ruajtur familjen nga brenda dhe nga jashtë, i është dhënë plotësisht burrit.



Cilat janë çështjet e tjera në të cilat burri duhet të ketë kujdes gjatë drejtimit të familjes?

Burri duhet të jetë i kujdesshëm ndaj kufijve fetar dhe, pa qenë i detyruar ai duhet të përpiqet të mos gjendet në ambientet ku punojnë burra dhe gra bashkërisht. Nëse mbetet i detyruar të punojë në këto ambiente pa dëshirën e tij, ai duhet të bëjë kujdes në sjelljet dhe shikimet e tij dhe të respektojë edukatën që ka urdhëruar feja jonë. Nëse është në pozitën e punëdhënësit, ai nuk duhet të bëhet shkak i një ambienti të tillë pune dhe, nëse është nevoja, ai duhet të organizojë vende ose kohë të ndryshme pune për burrat dhe për gratë veç e veç, duke e parandaluar kështu rënien në gabime të tilla. Në vendin e punës, e sidomos njerëzit me të cilët do të punojë kokë më kokë, duhet t'i zgjedhë prej gjinisë së vetë, duke qëndruar larg marrjes në punë të sekretareve me arsytetime të ndryshme. Për fat të keq, në ditët tona, këto sjellje të gabuara janë faktorë realë të divorceve dhe të shkatërrimit të familjeve.

Një burrë i mençur dhe i aftë, në marrëdhëniet me familjen dhe fëmijët e tij, duhet të tregohet tolerant dhe falës ndaj gabimeve të tyre në çështje të kësaj bote; ai duhet t'u afrohet atyre me mëshirë dhe butësi. Gjithashtu, ai duhet t'i mbajë fshehur të



gjitha sekretet dhe të metat e gruas së tij. Ndërsa ndaj mangësive dhe neglizhencave fetare, duhet të afrohet me seriozitet, duke vepruar me vendosmëri ndaj fenomeneve negative, si padituria ose përtacia (në çështjet fetare). Ai duhet të tregojë kujdes të madh në plotësimin e dijeve dhe veprave fetare të bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Në lidhje me këtë, ai duhet të përpiqet edhe vetë personalisht, por duhet të përfitojë edhe prej mësuesve të pjekur e të aftë në fushën e fesë. Këto, janë disa prej detyrave të baballarëve.

Burrat, duhet t'ia fitojnë zemrën familjeve të tyre duke u folur me fjalë të buta dhe të bukura, e nuk duhet t'i largojnë prej vetes me sjellje apo çehre të ashpër e të vrenjtur. Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Më i miri prej jush, është ai që sillet më mirë me gruan e tij.” (Ibni Maxhe, Nikah, 50)

Në lidhje me jetesën dhe menaxhimin e shtëpisë, burri duhet të këshillohet me gruan e tij. Por, punët e rënda nuk duhet t'ia lërë asaj. Ai duhet ta ndihmojë gruan e tij në lidhje me edukimin e fëmijëve, sepse edhe fëmijët, edhe punët e shtëpisë, e lodhin së tepërmi gruan. T'i ndihmohet ato në bartjen e kësaj barre të rëndë, është shkak i shtimit të dashurisë dhe mirëkuptimit ndërmjet bashkëshortëve. Gjithashtu, burri duhet të lutet për gruan, si në prezencë, ashtu



edhe në mungesë të saj. Ai nuk duhet të dalë për udhëtime të gjata, pa e lajmëruar gruan. Po ashtu, nuk duhet të sjellë në shtëpi pa lajmëruar mysafirë të panjohur. Ai nuk duhet të kërkojë prej gruas së tij, që ajo të dalë e t'u shërbejë personave të huaj, jashtë normave të lejuara islame. Dhe, me aq sa ka mundësi, ai duhet ta mbajë familjen larg ambienteve të mbipopulluara e të përziera.

Çfarë shpërblimesh do të arrijnë baballarët që marrin përsipër përgjegjësitë e drejtimit dhe menaxhimit të familjes me të gjitha hallet dhe barrët, nëse ata i kryejnë detyrat e tyre ashtu siç duhet?

Feja Islame, familjen ia ka besuar babait. Pra, në lidhje me sigurimin e të gjitha nevojave materiale e shpirtërore, i ka dhënë atij edhe përgjegjësi edhe autoritet të plotë. Për rrjedhojë, edhe pozita e kryetarit të familjes, i është caktuar babait.

Babai, është një diell në qiellin e lumturisë familjare, ndërsa nëna është një hënë, e cila në veten e saj, ka derdhur në argjend shkëlqimin e zemrës dhe perden e nderit. Kurse fëmijët, janë yje si perla në qiejt e virtytit.



Një baba, i cili ia ka kushtuar mendjen, fuqinë, vullnetin, dijen dhe përvojën e tij, edukimit, prosperitetit dhe përsosmërisë së familjes, pa asnjë dyshim, meriton respekt, bindje dhe dashuri. Mosbindja, kryeneçësia, mosmirënjohja dhe fjalët e këqija ndaj tij, nuk janë aspak të hijshme. Për këtë arsye, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Kënaqësia e Allahut, është e fshehur në kënaqësinë e babait. (Po ashtu) Edhe zemërimi dhe dënimi i Tij, është i fshehur në zemërimin dhe nevrikosjen e babait.” (Tirmidhi, Birr, 3)

Në familje, gruaja dhe fëmijët, nuk duhet t’ia kthejnë kurrë shpinën bindjes dhe respektit. Kjo, sepse dita kur shtëpia ngelet pa baba, është dita më e hidhur e jetës. Rëndësia që kanë ata për familjen, ndihet thellësisht në mungesë të tyre. Prandaj, atyre duhet t’u dihet vlera kur janë ende gjallë dhe, duke marrë duatë e mira prej tyre, duhet të tregohet bindje ndaj tyre në punët e lejuara. Ndërsa respekti ndaj tyre nuk duhet të mungojë kurrë.



*Çështjet
që duhet të kenë kujdes
burri dhe gruaja
së bashku në familje*



*Prindërit më të mëshirshëm,
janë ata që e përgatisin njëri-tjetrin
dhe fëmijët e tyre në devotshmërinë
ndaj Allahut.*

Burri dhe gruaja, ndërtojnë një çerdhe dhe duke bashkuar jetët e tyre, vendosin të ndajnë së bashku çdo gjë që mund t'u vijë në jetë. Por, cilat janë çështjet që të dyja palët duhet të kenë kujdes njëkohësisht gjatë jetës martesore?

Këtu, duhet bërë kujdes në dy pika:

- Në ndarjen e lumturisë dhe gëzimeve.
- Në ndarjen e barrës dhe vështirësive.

Ndarja e jetës së përbashkët, duhet të jetë e vazhdueshme në çdo gjendje të jetës, nën atmosferën e dashurisë dhe me frymë shpirtërore. Ashtu siç ndahen gëzimet dhe lumturitë, ashtu duhet të



ndahen edhe vështirësitë, hallet, hidhërimet dhe fatkeqësitë. Palët duhet ta mbështesin gjithmonë njëra-tjetrën, duke u bërë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Po ashtu, ata duhet të bëhen burimi më i afërt i ngushëllimit për njëri-tjetrin.

Jeta nuk vazhdon gjithmonë vetëm mbi re ngjyrë rozë. Nuk duhet harruar se, ajo ka ulje, ngritje, furtuna, kthesa dhe pengesa. Për njerëzit, e ardhmja është e panjohur dhe plot me surpriza. Kaderi (caktimi), është një e fshehtë hyjnore. Nga kjo pikëpamje, burimi më i madh i forcës dhe i mbështetjes, në radhë të parë duhet të jetë lidhja dhe besimi në Allahun. Ndërsa mbështetja e dytë më e madhe, janë bashkëshortët e lidhur fort me njëri-tjetrin.

Duhet pasur kujdes se, nëse njerëzit e pashpresë e të lodhur, nuk e gjejnë brenda familjes mbështetjen e pritur në raste të fatkeqësive dhe vështirësive, ata mund të pësojnë rrënime dhe shkatërrime edhe më të mëdha. Mirëpo, në çerdhet familjare të cilat përbëhen nga individë të pjekur shpirtërisht dhe të kuptueshëm, fatkeqësitë që vijnë, anashkalohen me lehtësi, në bazë të qëndrueshmërisë së familjes.

Qëndrueshmëria familjare, në mënyrë paralele me pjekurinë shpirtërore, në mënyrë të veçantë, varet edhe nga aftësia në mirëkuptimin reciprok. Ky, është kushti më i rëndësishëm i shumë mirësive dhe



sukseseve. Lidhur me këtë, Mevlana, thotë:

“Trëndafili, aromën e këndshme, e ka fituar për shkak se ia ka kaluar bukur me gjembin. Këtë të vërtetë, dëgjoje edhe prej vetë trëndafilit. Dëgjo se ç’thotë: «E përse të hidhërohem se jam bashkë me gjembin; përse ta fus veten në stres? Unë, që të qeshurën e fitova për shkak se durova qëndrimin bashkë me gjembin e keq. Në sajë të tij, unë arrita mundësinë t’i ofrojë botës bukuri dhe aroma të këndshme...»”

Ky trëndafil, na thotë edhe neve:

“Edhe ju bëhuni si unë!”

Çfarë duhet pasur kujdes në formimin e një familje të tillë, të shëndetshme dhe të fortë?

Pikësëpari, lumturia në familje, është diçka që mund të realizohet në mënyrë dypalëshe. Dhe, themelin e kësaj, e përbëjnë:

1. Të kalohet mirë me njëri-tjetrin.
2. Të sillesh me mirëkuptim dhe pjekuri.
3. Të jesh sakrifikues.



Dhe këto, janë të mundura vetëm me moral, mençuri, zgjuarsi, sinqeritet dhe ndjenja reciproke. Gjithashtu, për të kaluar mirë, tek të dyja palët duhet të gjenden këto pesë cilësi:

1. Fetaria
2. Virtyti
3. Dashuria
4. Mëshira
5. Besnikëria

Është shumë e domosdoshme që këto cilësi, të gjenden edhe tek gruaja edhe tek burri. Kjo domosdoshmëri, bëhet më e qartë në sajë të fatkeqësive familjare që ndodhin përditë.

Ashtu si në shoqëri, edhe në familje, fetaria dhe virtyti janë themeli i të gjitha cilësive të bukura. Çerdhet familjare ku feja jetohet në mënyrën më të bukur dhe ku shfaqen virtytet morale, i falin njerëzve lumturinë e të dyja botëve. Përndryshe, në rastet kur feja neglizhohet dhe si rezultat ndodh dobësi morale, siç dëmtohen individët në familje, ashtu dëmtohet rëndë edhe shoqëria.

Çështja e fetarisë të cilën po e theksojmë këtu, duhet kuptuar mirë. Njeriu nuk mund të jetë edhe fetar, edhe i ashpër, i pasjellshëm dhe i vështirë, sepse feja Islame, përbëhet e gjitha prej mirësjelljes,



delikatesës dhe edukatës. Pra, feja është edukatë e bukur, edukatë e bukur, edukatë e bukur... Siç shprehet edhe poeti:

Edukata, një kurorë ishte prej dritës hyjnore

Vëre atë kurorë, të shpëtosh prej çdo belaje...

Ndërsa i nderuari Mevlana, thotë:

“Mendja iu afrua veshit të zemrës sime dhe e pyeti:

«- Ç’është feja?»

Ndërsa zemra ime iu përgjigj:

«- Feja është veç edukatë.»”

Për sa i përket dashurisë; ajo është majaja dhe ushqimi i familjes. Kur dashuria pakësohet dhe konsumohet pa kujdes, edhe familja fillon të lëkundet. Edhe dashuria duhet të jetë reciproke, sepse ajo i përgatit zemrat të ndikohen nga njëra-tjetra. Njeriu, duhet fort aq sa dashuron. Me shtimin e dashurisë nga njëra palë, edhe sjelljet dhe fjalët e palës tjetër duhet të jenë të buta dhe të zbukurohen me mirë-sjellje, delikatesë dhe respekt.

Dashuria, në asnjë mënyrë nuk duhet kthehet në pakujdesi sjelljesh dhe, gjithmonë duhet ruajtur edukata brenda një kornize të caktuar. Dashuria, mëshira dhe të gjitha ndjenja e ngjashme me këto, duhet të jenë gjithmonë të ekuilibruara. Ashtu siç



sjell dëme dashuria e tepruar, ashtu edhe privimi i plotë i të dashurve tanë prej dashurisë sonë, mund t'i çojë ata t'i kërkojnë këto ndjenja në ndonjë vend tjetër.

Nëse dashuria realizohet vetëm në planin epshor dhe i kalon kufijtë, ajo i hap rrugën një xhelozie dhe presioni të egër, ose mund edhe të pakësohet. Dhe këto dy gjendje, janë nga një fatkeqësi më vete për çerdhen familjare.

Në mënyrë të njëjtë, edhe mëshira duhet të jetë larg prej teprimit dhe moskujdesit. Mëshira e tepruar, e bën njeriun të dobët, duke e bërë atë tolerant edhe ndaj gabimeve të dëmshme dhe shkatërruese. Kjo, nuk është mëshirë, por vetëm një dobësi e zemrës. Nga ana tjetër, edhe mungesa e mëshirës, e ngurtëson zemrën, duke e çuar njeriun në padrejtësi dhe mizori. Ndërsa mëshira mesatare, e një niveli të ëmbël dhe të ashpër, është shumë frytdhënëse dhe sjell lumturi në çerdhen familjare.

Prindërit më të mëshirshëm, janë ata që ngrenë veten dhe fëmijët e tyre në namazin e sabahut, duke i përgatitur ata në çdo aspekt, për lumturinë e botës tjetër.

Ndërsa për sa i përket besnikërisë, edhe ajo është një çështje së cilës duhet t'i japin rëndësi të dyja palët. Siç tregon edhe vetë kuptimi i fjalës, besnikëri



do të thotë të mbash premtimet, të jesh i drejtë në fjalë e në vepra dhe të mos flasësh gënjeshtër.

Padyshim se, për të siguruar shëndetin dhe vazhdimësinë e martesës, është shumë e rëndësishme që bashkëshortët të jenë të drejtë me njëri-tjetrin në çdolloj situatë dhe të qëndrojnë larg çdo sjelljeje që e cenon besimin ndërmjet tyre. Po ashtu, një nga kushtet e domosdoshme për shëndetin e martesës, është që burri dhe gruaja të jenë besnikë ndaj njëri-tjetrit, pra, që zemrat dhe sytë e tyre të mos rrëshqasin tek njerëzit e tjerë. Për të mos rënë në këto lloj rreziqesh, është e domosdoshme të tregohet kujdes ndaj rregullave dhe parimeve që Islami ka vendosur në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet burrave dhe grave të huaj ndaj njëri-tjetrit.

Të veprosh në një mënyrë që ngjallë dyshime, hamendje, thashetheme dhe vesvese tek njerëzit, e cenon edhe nderin dhe respektin e personit, por që në rrezik edhe çerdhen familjare.

Një manifestim tjetër i besnikërisë dhe përkushtimit, është edhe respekti dhe shërbimi që të dyja palët i bëjnë prindërve të njëri-tjetrit. Në këtë aspekt, nuset dhe dhëndurët tanë, duhet të tregojnë interes për vjehrrën dhe vjehrrin, ashtu siç tregojnë edhe për prindërit e tyre. Nesër, edhe ata do të jenë në të njëjtën pozitë. Nëse veprojnë keq, edhe ata do të



përballen me të një ditë. Siç shprehen edhe të vjetërit: “Kush bën keq, gjen keq!”, ose “Ç’të mbjellësh do të korrësh!”, apo “Bota është me rrota.”

Në martesë, detyra e sigurimit të jetesës, i takon burrave. Po në çështjen e menaxhimit të ekonomisë familjare, vetëm burrat kanë përgjegjësi?

Feja Islame, detyrën e përballimit të shpenzimeve në çështjen e sigurimit të jetesës së familjes, ia ka ngarkuar burrit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ai duhet të plotësojë menjëherë çdo kërkesë të pjesëtarëve të familjes. Nevojat e domosdoshme dhe të arsyeshme, duhen siguruar brenda mundësive. Madje, edhe nëse është i pasur, nuk duhet që njeriut t’i plotësohet çdolloj dëshire e mundur apo e pamundur, sepse të bësh gjithçka që dëshirohet, me kalimin e kohës i fryn dëshirat dhe kërkesat, gjë e cila bëhet shkak i pangopshmërisë së egos, arrogancës dhe kryeneçësisë së saj. Një njeri i tillë, dalëngadalë bëhet egoist dhe bie në vorbullën e të menduarit vetëm për veten e tij. Dhe, duke menduar se e gjithë familja janë skllëvër të tij, ai fillon të abuzojë me gjithçka.



dhe i përdor ato vetëm në drejtim të dëshirave të egos së tij, do të thotë se ai është kthyer në një “kalë” që nuk pranon frerë. Për këtë arsye, shtyrja e disa dëshirave të zjarrita edhe pse është e mundur të plotësohen, është një kusht i domosdoshëm, me qëllim që njeriu të shkelë me këmbë në tokë, të shohë të vërtetat e jetës dhe të fitojë kënaqësinë e Allahut. Nuk duhet harruar se, durimi i vërtetë, është durimi në pasuri, sepse pasuria është një element provokues i vazhdueshëm.

Ndjekja e një metode edukimi në rrugën e pjekurisë së njeriut duke mos e bërë menjëherë atë që kërkon ai, në të njëjtën kohë, është edhe një urtësi hyjnore. Allahu i Madhëruar, ndonjëherë nuk i pranon duatë (lutjet) dhe kërkesat e robërve të Tij, ndonjëherë i shtyn ato, e ndonjëherë i pranon. Qëllimi i kësaj, është që njerëzit të mos lidhen plotësisht pas kësaj bote të përkohshme dhe, të kuptojnë nevojën për Allahun pa u llastuar në mes të të mirave. Kjo, sepse njeriu edhe nëse është duke hequr një mije e një vuajtje dhe nuk i arrin dëshirat e veta, ai nuk dëshiron të shkëputet nga kjo botë. Dhe, po t'i plotësohet çdo dëshirë, e të arrijë të gjitha ëndrrat, ai nuk do të dëshirojë kurrë të ndahet nga kjo botë dhe mund të zhytet në gabime më të mëdha, madje edhe në mosbindje ndaj Allahut.



Në fakt, edhe Ademi (a.s.), bëri një gabim për shkak se nuk donte të ndahej nga xheneti. Por më në fund ai u zbrit prej atje. Nga kjo pikëpamje, në edukimin e fëmijëve dhe në plotësimin e dëshirave të tyre, duhet vepruar duke pasur parasysh edhe momentet e vështira me të cilat do të përballen në të ardhmen, por edhe Ditën e Llogarisë në botën tjetër.

Sigurisht që, t'i shkurtosh shpenzimet në mënyrë të tepruar duke e çuar punën në koprraci dhe të mos pranosh përballimin e disa nevojave të detyrueshme jetësore, nuk është as e drejtë dhe as e pranueshme si sjellje. Në këtë çështje, duhet ndjekur një vijë e mesme midis këtyre dy gjendjeve. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes.” (Furkan, 67)

Kjo rrugë e mesme, është ekuilibri i jetës. Aq sa e keqe është koprracia, aq i keq është edhe shpërdorimi. Sado të pasur të jenë, burri ose gruaja, kurrë nuk kanë të drejtë të shpërdorojnë dhe ta përdorin pasurinë në mënyrë të pakontrolluar. Askush nuk mund të thotë: “Kjo është pasuria ime, e shpenzoj si të dua...” Allahu i Madhëruar, i Cili ua ka dhënë si amanet atë pasuri, në Ditën e Kiametit, do të pyesë një nga një llogarinë e çdo lloj shpenzimi, duke



thënë: “Ku dhe për çfarë e shpenzove pasurinë?”. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepëruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e shejtanit dhe, shejtani është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.” (Isra, 26-27)

Islami, e ka ndaluar për të gjithë njerëzit çdolloj të shpërdorimit. Ai nuk bën dallim se nga kush vjen shpërdorimi në familje, nga burri apo nga gruaja. Kjo është një sëmundje e keqe e cila duhet penguar. Nëse kjo sëmundje ka zënë vend në shpirtin e njeriut, ai njeri e ka të vështirë të jetojë i qetë dhe në rehati.

Kjo sëmundje, që në ditët tona njihet si “çmenduria e konsumit”, të bën të mosmjaftohesh me atë që ke, duke ta bërë normale ambicien dhe dëshirën për gjëra të reja dhe të veçanta. Ndërrimi i sendeve shtëpiake me më të reja pa pasur asnjë nevojë, si telefonin, veshjet, makinën dhe të tjera të ngjashme me këto; të blesh veshje të reja për shkak të ndërrimit të “modës”; apo të veshësh vetëm rroba të një marke të caktuar, etj., janë të gjitha dobësi të njerëzve që kanë rënë në kthetrat e kësaj sëmundjeje. Ndërsa rezultati, një dështim total! Fundi i atyre që marrin borxh kur u mungojnë mundësitë personale, duke përdorur karta krediti, e sidomos duke u përlyer me



kamatë, vetëm për të plotësuar dëshirat dhe ambiciet e tyre, është me të vërtetë shumë i keq. Njerëz të tillë, për shkak se janë të mbytur në batakun e borxheve, fillojnë dhe i akuzojnë njerëzit përreth duke thënë: “Nuk më ndihmojnë!”.

Kjo gjendje, është rezultat i hidhur i pamundësisë së përdorimit të mendjes dhe ndjenjave në mënyrë të ekuilibruar. Për rrjedhojë, në vend të shpenzimeve të çmenduara, duhet t’i drejtohem begatisë së durimit, sepse edhe ngushticën edhe bollëkun, Allahu ua jep njerëzve gjithmonë me qëllim të një urtësie ose sprove, pra, për t’u bërë shkak i durimit dhe falënderimit.

Duhet menduar se, sado i fuqishëm të jetë në aspektin material, mundësitë e pakta, e afrojnë më shumë robin tek Allahu. Gjithmonë, aty ku mbarojnë mundësitë, njeriu thotë: “O Zot!”, duke e kujtuar Allahun. Ajo që e bën njeriun njeri, është ndjenja e dobësisë.

Të dashurit e Allahut, kriteret e veshjes, i kanë ndarë sipas nivelit të zemrave të besimtarëve:

- Veshja sipas sheriatit, është të mos i kalosh kufijtë në aspektin e hallallit dhe haramit.

- Veshja sipas devotshmërisë, është të mos kalosh përtej kufirit të nevojës.



- Ndërsa veshja sipas ihsanit, është të mos tregosh dashuri dhe interes të tepruar ndaj veshjeve. Domethënë, të vishesh pastër e thjeshtë dhe të mos e angazhosh zemrën me këtë çështje...

Nëse njeriu me të vërtetë has vështirësi në gjetjen e një vendi për të shpenzuar paratë e tij dhe, për këtë arsye priret të shpërdorjë, duhet të ketë parasysh se, ai mundet edhe t'i zgjasë dorën e ndihmës njerëzve më nevojtar se vetja e tij. Edhe nëse ai e jep këtë ndihmë, atëherë duhet ta shtojë edhe më shumë. Një njeri i cili mendon se në paratë e fituara kanë të drejtë edhe të varfrit, nevojtarët dhe jetimët, nuk e shpenzon pasurinë e tij në mënyrë të bollshme. Islami, ashtu siç ka vendosur parime për mënyrën dhe vendin e fitimit të parave, ka përcaktuar edhe fushat ku mund të shpenzohen dhe ku është e ndaluar të shpenzohen ato. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”

(Bekare, 195)

Nuk duhet harruar asnjëherë se, në një kohë dhe vend ku njerëzit po përpëliten në mes të urisë dhe mjerimit, edhe çdo qindarkë e shpenzuar si shpërdorim, është një llogari e vështirë që do të jepet në botën tjetër.



Nga kjo pikëpamje, çdo ditë para se të bie në gjumë, njeriu duhet të meditojë rreth mirësive që gëzon dhe, për këto duhet të falënderojë Allahun e Madhëruar. Duhet menduar se:

Të flesh i ngopur, ndërkohë që në botë ka shumë njerëz të uritur e të etur; të kesh mirëqenie dhe siguri ndërkohë që në botë ka shumë njerëz në skamje dhe në rrezik; të kalosh natën i qetë në krevat, ndërkohë që mijëra njerëz kanë ngelur pa strehë për shkak të fatkeqësive, është edhe një mirësi e madhe, por edhe një përgjegjësi shumë e madhe.

Një llogari e tillë e bërë çdo ditë para se të biem në gjumë, duhet të ketë një vend të paneglizhueshëm në jetën tonë të meditimt. Omeri (r.a.), i cili ka thënë: *“Llogaritni veten para se të llogariteni”*¹², çdo natë i kërkonte llogari vetes dhe kontrollonte ndërgjegjen e tij, me shprehje të tilla si: *“Nëse një dele bie në ujë dhe mbytet në brigjet e lumit Tigër, Allahu do t’i kërktojë llogari Omerit.”*, *“Çfarë ke bërë sot për Allahun, o Omer?”*, etj.

Vallë po ne, sa herë i kemi përjetuar ashtu siç duhet këto ndjenja? Sa net i kemi nënshtruar zemrat tona ndaj një llogarie të tillë, ndërkohë që gjatë ditës ato kanë qenë të zëna me telashet e kësaj bote?



Tek njerëzit që e mbajnë të gjallë brenda tyre këtë ndjenjë të vetllogaritjes, shfaqet një cilësi që u siguron atyre qetësinë dhe sigurinë shpirtërore. Dhe kjo, është “mjaftueshmëria”!..

Mjaftueshmëria, është pasuria më e madhe. Niveli i pasurisë së zemrës së një njeriu, matet vetëm me mjaftueshmërinë e tij. Njeriu që mjaftohet me atë që zotëron, di se si të menaxhojë edhe mundësitë që ka. Kjo, i qetëson ata shpirtërisht dhe i bën të kënaqur me kaderin (cakimin) e Allahut. Mirëpo, kjo në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar si dembelizëm dhe largim prej jetës së punës. Përkundrazi, ajo që duam të themi, është se pasi të punohet në mënyrë të ekuilibruar dhe brenda normave të lejuara, duhet të jesh i kënaqur me atë që të jep Allahu. Ai që është i kënaqur me atë që zotëron, përpiqet të ndihmojë edhe të tjerët me aq sa ka mundësi. Mirëpo, ai që nuk e sheh të mjaftueshme atë që zotëron, gjithmonë kërkon më tepër dhe jo vetëm që nuk i ndihmon të tjerët, por gjithmonë pret të ndihmohet nga të tjerët.

Shoqëria në “epokën e lumturisë”¹³, ku janë përjetuar të gjitha këto virtyte që përmendëm dhe shumë tjera si këto, ishte një shoqëri e cila kish-

13. Epoka e Lumturisë: Koha kur Pejgamberi (a.s.), ka qenë në mesin e besimtarëve.



te arritur horizontin e vetëdijes së **“takimit me Allahun”**. Ajo, ishte periudha e virtytshme e njohjes nga afër dhe nga zemra e Allahut të Madhëruar dhe Pejgamberit (a.s.). Në atë shoqëri, ambiciet e kësaj bote u nxorën nga zemra. Pasuria dhe jeta, u përdorën vetëm si një mjet për t’u afruar sa më shumë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Besimi u bë i ëmbël dhe mëshira u zgjerua. Shërbimi ndaj krijesave të Allahut, u bë një stil jetese. Ndjekja e Resulullahut (a.s.), në çdo gjendje të tij, u bë ideali më i madh i sahabëve. Çdo këshillë dhe porosi që jepte Resulullahu (a.s.), u respektua si një urdhër i shenjtë dhe u zbatua me kujdes. E gjithë shoqëria jetoi me kriterin e mjaftueshmërisë. Konsumi i tepërt, luksi, shpërdorimi, grykësia dhe mburrja, ishte një mënyrë jetese që rrethi i sahabëve dhe shoqëria e tyre nuk e njihte aspak. Zemrat e tyre, e kishin pranuar realitetin se, “ky trup që strehon egon tonë, nesër do të bëhet varr”.

Në qendër të miqësisë, u vendosën Allahu dhe i Dërguari i Tij. Një shoqëri, që më parë nuk dinte shkrim e këndim, me t’u regjistruar në shkollën e Islamit dhe besimit, kapën majat e civilizimit. Të gjitha zemrat jetuan me ndjenjat: “Çfarë kërkon Allahu prej nesh? Çfarë dëshiron të shohë Resulullahu tek ne?” Jeta, u lidh pas kënaqësisë së Allahut. Mëshira dhe dhembshuria u thelluan; ndërsa ndjeshmëria ndaj



hakut dhe të drejtës u ngrit në majat më të larta. Për sahabët, çastet më me kuptim dhe më me kënaqësi të jetës, ishin ato kur përçonin tek njerëzit mesazhet e shpalljes hyjnore. Sot, edhe ne duhet të ndjekim karvanin e virtyteve të tyre, me qëllim që të arrijmë ngritjen shpirtërore si individë dhe të njëjtën paqe dhe mirësi si shoqëri.

Pikërisht me këto virtyte duhet të brumosen edhe prindërit, të cilët do të edukojnë fëmijët e tyre në po të njëjtën mënyrë. Në mënyrë të veçantë, ata kurrë nuk duhet të bëjnë dallime midis fëmijëve. Ata duhet të bëjnë kujdes në drejtësi dhe barazi, qoftë midis djalit dhe vajzës, qoftë midis fëmijëve të së njëjtës gjini. Për shembull, diçka që i merr njërit, duhet t'ia marrë edhe tjetrit; kur e puth njërin, nuk duhet ta lërë pas dore as tjetrin. Pra, në asnjë mënyrë nuk duhet të bëhet shkak që midis fëmijëve të lulëzojnë farat e smirës.

Gjithashtu, edhe fqinjët duhet të zgjidhen prej njerëzve të mirë, duke bërë kujdes në marrëdhëniet midis fqinjëve dhe të afërmeve me moral të keq dhe dobësi në çështjet fetare. Pra, ndërkohë që përpiqet t'i këshillojë dhe porositë për mirë, nuk duhet të vërë në rrezik familjen dhe fëmijët e tij.



FJALA E FUNDIT

Jeta familjare, e cila filloi me krijimin e njeriut, është padyshim pasqyra më e rëndësishme që do të përcaktojë rezultatin që do të arrijmë në udhëtimin tonë të pafundësisë. Kjo, sepse familja, është mejtepi i parë, dashuria e parë, lumturia e parë dhe xheneti i parë, ku edukohen edhe ndjenjat, edhe vullneti i njeriut. Pra, vendi ku edukohen edhe mendja, edhe zemra e tij në këtë botë, e cila nga një pikëpamje është ara ku njeriu mbjell për botën tjetër.

Për rrjedhojë, kjo çerdhe e shenjtë, duhet të arrijë identitetin e saj në çdo aspekt dhe duhet të jetë atmosfera më ndikuese në jetën tonë. Martesat që përfshijnë një jetë të tërë në ambientin familjar, nuk duhet të shkaktojnë mërzi, nuk duhet ta ulin vlerën dhe respektin për njëri-tjetrin, por përkundrazi, duhet të bëhen si monumente madhështore të cilat zbukurohen dhe u rritet vlera me kalimin e viteve.

Për këtë arsye, neve na duhet ta rishikojmë botë-kuptimin tonë ndaj çerdhes familjare. Ajo çerdhe,



nuk është as një hotel dhe as një arenë indiference. Ajo, është një kopsht zemre ku mblidhen frutat e dashurisë, pasionit dhe shërbimit të përkushtuara ndaj kënaqësisë së Allahut. Nëse trëndafilat, zambakët dhe bilbilat e këtij kopshti, janë gjithmonë në një atmosferë pranverore, është shumë e mundur që edhe në Ditën e Kiametit, fati ynë të ketë bukurinë pranverore.

Shkurtimisht, çerdhja jonë familjare;

Nuk duhet të bëhet shkak, që në Ditën e Kiametit prindërit dhe fëmijët t'i ikin njëri-tjetrit, por një vend i bukur jetese ku ata do ta përqafojnë me mall e me shpirt njëri-tjetrin. Dhe për këtë, njeriu duhet të bëjë kujdes që tani, me qëllim që çfarëdo që të bëjë, sido që të jetojë, pjesëtarët e familjes të mos ikin prej njëri-tjetrit, por që të gjithë të bëhen ndërmjetës dhe shpëtues për njëri-tjetrin në atë ditë!..

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Si të jetoni, ashtu do të vdisni; si të vdisni, ashtu do të ringjalleni!..” (Munavi, Fejdu'l-Kadir, V, 663)

Ditën që në familje do të ndërtohet një përkushtim dhe lidhje me këtë frymë dhe këto kritere, ajo çerdhe, jo vetëm që do të jetë një atmosferë triumfuese dhe shpirtërore në botën tjetër, por edhe në këtë botë do të bëhet shkak i bukurive, paqes dhe



gjallërimit të madhështisë për të gjithë shoqërinë.

Allahu i Madhëruar na faltë të gjithëve çerdhe të tilla familjare! E bashkoftë të gjithë umetin dhe rininë tonë me ndjenjat e besimit, dijes, pasionit, dashurisë, altruizmit, sakrificës, shërbimit dhe lumturisë së përjetshme!.. Dhe prej këtyre çerdheve të ngrohta familjare të ndërtuar në këtë mënyrë, na dhëntë njerëz besimtarë, të aftë, të ndërgjegjshëm dhe me karakter të fortë!

Amin!..



PËRMBAJTA

Parafjalë.....	5
Nikahu dhe familja në Islam.....	11
Çështjet që duhet të kenë kujdes gratë në familje.....	53
Çështjet që duhet të kenë kujdes burrat në familje.....	75
Çështjet që duhet të kenë kujdes burri dhe gruaja së bashku në familje.....	93
Fjala e fundit.....	113



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Topbas, Osman Nûri

Xheneti i kësaj bote, çerdhja e ngrohtë
familjare / Osman Nuri Topbash ; përkth.

Ilir Hoxha ; red. Zija Vukaj. – Shkodër :

Progres, 2016

118 f. ; 11 x 18 cm.

Tit. origj.: Dünyadaki cennet, huzurlu aile yuvası

ISBN 978-9928-207-05-0

1.Feja islame 2.Familja

28 -45